LEKSIKON HITITISHT-SHQIP
përkime dhe paralele linguistike

HITTITE-ALBANIAN LEXICON
Cognates and Linguisitic Parallels

Kujtim Mani

FAIK KONICA

Kujtim Mani (1968)
është hulumtues në Institutin
Albanologjik të Prishtinës. Doktoroi
në filologji më 2002; bëri kërkime
pasdoktorale në qendra të ndryshme
universitare: Berlin, Hajdelberg,
Louven, Paris, Uashington,
Londër, Frajburg etj. Fushat
themelore të interesit:
studime letrare,
linguistikë,
antropologji.

Disa nga librat e autorit:

Antropoetikë (2008)
Taksa e gjumit (2017)
Kreshniku NATURALIS (2020)
Mbishkrimet mesape (2024)

LEKSIKON HITITISHT-SHQIP
përkime dhe paralele linguistike

HITTITE-ALBANIAN LEXICON
Cognates and Lingusitic Parallels

Kujtim Mani

Redaktor / Editor:
Nazmi Rrahmani

© 2025 by Kujtim Mani

Ky botim/projekt u financua nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

LEKSIKON HITITISHT-SHQIP
përkime dhe paralele linguistike

HITTITE-ALBANIAN LEXICON
Cognates and Linguistic Parallels

Kujtim Mani

Shtëpia botuese
FAIK KONICA
Prishtinë
2025

PËRMBAJTJA / CONTENT

Fjalë pragu 7
Lexical Threshold 11

PARALELE HITITO-SHQIPE 15

HITTITE-ALBANIAN PARALLELS 15

Mbi lidhjet Hitito-Shqipe 17
Ndërrimet fonologjike hitito–shqipe 26
Paralele morfo–semantike 42
Huazimet leksikore 48
Paradigmat semantike hitito-shqipe 57
Paradigma *arai-* 58
Paradigma *damme-* 62
Paradigma *alel-* 63
Paradigma *app/epp* 64
Paradigma *ispar-* 67
Paradigma *ulippana-* 69
Etymon-trekëndshi: hititisht – mesapisht – shqip 75
Përfundim 78
On Hittite-Albanian Links 81
Hittite–Albanian Phonological Shifts 90
Morpho-Semantic Parallels 106
Lexical Borrowings 112
Hittite–Albanian Semantic Paradigms 121
The *arai* paradigm 121
The *damme-* paradigm 125
The *alel-* paradigm 127
The *app/epp* paradigm 128
The *ispar* paradigm 131
The *ulippana* paradigm 133
The Etymon Triangle: Hittite – Messapic – Albanian 139
Conclusion 142

LEKSIKON KORRESPONDENCASH 145

LEXICON OF CORRESPONDENCES 145

- A - 147
- E - 164
- H - 168
- I - 195

- K - 205
- L - 222
- M - 228
- N - 238
- P - 241
- S - 260
- T - 279
- U - 298
- W - 306
- Z - 316

BURIMET / SOURCES 320

REFERENCAT / REFERENCES 321

Fjalë pragu

Ç'është ky leksikon; ku na shpie?

Gjatë punës sime disavjeçare me *mbishkrimet mesape*, më duhej të ndiqja fijet etimologjike të fjalëve që shpesh më udhëzonin drejt botës gjuhësore anatoliane. Krejt pahetueshëm kisha rrëshqitur drejt kërkimit të korrespondencave mes hititishtes e shqipes, të cilat ishin shfaqur gjithnjë e më të pasura, si në numër, ashtu edhe në forma gramatikore.

Megjithatë, më doli se studimet mbi këto lidhje kishin ngecur në vend, për shkak të perceptimit të gjatë të shqipes si degë e izoluar brenda familjes indoevropiane; ishin studiuar kryesisht lidhjet me greqishten, latinishten, sllavishten dhe turqishten, por ishin shpërfillur gjithandej lidhjet me gjuhët anatoliane. Ky kornizim historik kishte errësuar hartën strukturore të marrëdhënieve të lashta gjuhësore të shqipes, duke u shtrirë edhe në periudhën e mesjetës.

Pas disa vitesh kërkime, m'u bë e qartë se gjetjet tejkalonin të gjitha pritshmëritë fillestare: hititishtja, mbase më shumë se sanskritishtja, tregonte lidhje të thella me shqipen. Kuptova se venerime të tilla kërkojnë vëmendje të përkushtuar ndaj fjalëve, formave gramatikore dhe nuancave semantike. Duke krahasuar në mënyrë sistematike materialin leksikor hitit/anatolian me atë shqiptar – me mpleksjen e korrespondencave fonologjike, zhvillimeve semantike, morfologjisë derivuese dhe kontekstit ritual-kulturor – ky leksik synon të shkojë përtej analizave klasike fonologjike dhe leksiko-statistikore.

Evidencat e këtushme flasin se shqipja ruan një korpus të ngjeshur fjalësh arkaike indoeuropiane, përfshirë forma të ngjashme me rrënjët anatoliane, duke e pozicionuar shqipen si

dëshmitare kryesore të shtresave të hershme PIE dhe jo si një degë periferike. Kthyer në numra, këtu janë vërejtur me qindra korrespondenca që nënkuptojnë përkime, zhvillime paralele e njësi të ndryshme idiomatike, të cilat përbëjnë edhe bazën e fjalorit të trashëguar të shqipes, krahas huazimeve, hamendësimeve e propozim-përkimeve, gjithashtu qindra sosh, të cilat janë sjellë sa për kureshtje dhe për qëllime studimesh gjuhësore komparative. Dallimi mes përkimeve dhe huazimeve nuk është dhënë në tekst, për shkak të gjerësisë së materialit, dhe duke lënë po ashtu në dorë të studiuesve nxjerrjen e përfundimeve për karakterin historiko-gjuhësor të një korrespondence, përkimi a huazimi.

Ky punim duhet kuptuar kryesisht si një kërkim hyrës – si hap i parë i një shoshitjeje më të thellë të përkimeve hitito-shqipe, me synim identifikimin e paralelizmave themelorë leksikorë dhe strukturorë, duke ofruar një orientim fillestar për studiuesit e pritshëm. Rrjedhimisht, *zërat* e këtij leksikoni janë sjellë kryesisht në nivel përkimesh semantike, leksikore, hititisht-shqip, pa bërë komente të detajuara fonologjike e morfologjike.

Pa dyshim, një studim i detajuar që do të mund të pasonte, do duhej të kthente kryet kah mbledhja e një korpusi më të gjerë korrespondencash, duke dëshmuar më sistematikisht dhe te më shumë raste ndërrimet fonologjike të propozuara dhe ligjet fonetike që dalin nga gjedhet që shënojnë rregullsi. Vëzhgimet e thelluara do të mund të merreshin më saktë me fonologjinë dhe morfologjinë e korrespondencave të mundshme, duke i parë ato sipas shkallës së përkimësisë, nga *të fortat*, te *të besueshmet*, *të mundshmet* dhe ato që vijnë thjesht si *spekulative*, duke nënkuptuar këtu rregullsinë fonologjike, përshtatjen semantike dhe ndikimet a huazimet e mundshme. Këtu do përfshiheshin edhe propozime rikonstruktimi, duke përfshirë format PIE ose të ndërmjeme, me komente të shkurtra mbi qëndrueshmërinë e tyre. Një analizë sistematike fonogramatikore, duke përfshirë paradigma të plota në shumë klasa rrënjësh, do ishte thelbësore

për të kuptuar përkimet e rregullta dhe për të ndriçuar ngjashmëritë apo dhe dallimet midis këtyre gjuhëve.

Këso dore, i këtillë si është, ky leksikon duhet të shihet si një hartë orientuese fillestare në përkime të rëndësishme, por duke propozuar herë-herë edhe lidhje më spekulative që gjasojnë me 'stisje-homologjira' e 'inovacione folk-etimologjike'.

Fundja, i tërë ky punim s'është veçse mishërim-eksplorim njomëzak i një dialogu – sa të lashtë po aq bashkëkohor – duke u shtrirë gjeregjatë prej hititishtes e shqipes drejt rrjeteve të ndërlikuara të marrëdhënieve gjuhësore që ndriçojnë origjinën dhe evolucionin e gjuhës.

Lënda leksikore mbi të cilën u punua ky leksikon, është vjelë kryesisht nga fjalorët e hititishtes, të Tischlerit, Puhvelit e Kloekhorstit, gjithnjë duke bërë krahasime me burime të tjera. Nëse, siç ka vënë re së fundmi Melchert, këta tre studiues shpërfaqin pikëshikime të ndryshme mbi etimologjinë hitite, qasja ime ka mëtuar të ruajë një konsistencë metodologjike dhe të shmangë për aq sa është e mundur dallimet mes tyre.

Nuk mund të mos shpreh mirënjohjen time të thellë ndaj gjithë kolegëve e miqve që m'u gjendën pranë në këtë ndërmarrje. Pa dyshim, borxhi më i thellë shkon për profesorin H. Craig Melchert (UCLA), indoevropianistin e pashoq dhe maestron e hititishtes, i cili m'u ndodh pranë me komente, propozime e qortime fort të vyera. Jo pak nga sugjerimet e tij që lypin aq punë, mbeten të plotësohen në të ardhmen, për shkak të vetë natyrës hyrëse të këtij projekti.

Për gjithë gabimet e të pabërat – m'u nxiftë faqja vetëm mua!

Lexical Threshold

What is this lexicon, and to what horizons might it guide us?

Over the course of a few years working on Messapic inscriptions, I pursued numerous etymological threads that repeatedly drew me into the Anatolian linguistic domain. Almost inevitably, this drew me into the study of Hittite–Albanian correspondences, which revealed themselves to be unexpectedly rich – both in sheer number and in grammatical form.

Yet research into these connections has remained largely stagnant, shaped by the long-standing perception of Albanian as an isolated branch within the Indo-European family. Traditionally, Albanian has been studied primarily in relation to Greek, Latin, Slavic, and Turkish, while its potential ties to Anatolian languages have been overlooked. This framing has obscured the structural map of Albanian's deepest linguistic relationships, even into the medieval period.

After several years of investigation, the findings far surpassed my initial expectations: Hittite, perhaps even more than Sanskrit, displayed profound and systematic connections with Albanian. These discoveries demand close attention to lexical items, grammatical structures, and semantic nuance. By tracing phonological, semantic, and morphological correspondences alongside ritual-cultural patterns, this lexicon situates Hittite /Anatolian and Albanian material within a framework that goes beyond classical phonological and lexicostatistical analysis.

The evidence demonstrates that Albanian preserves a substantial corpus of archaic Indo-European vocabulary, including forms closely aligned with Anatolian roots. This positions Albanian as a primary witness to early PIE strata rather than as

a peripheral branch. In quantitative terms, hundreds of correspondences have been identified, comprising cognates, parallel developments, and idiomatic formations that together constitute the inherited lexical core of Albanian**.** In addition to these, a further set of several hundred loanwords and tentative or speculative correspondences has also been included –presented partly out of scholarly curiosity and partly to facilitate comparative investigation. The distinction between correspondences, particularly between inherited cognates and borrowings, has not been drawn systematically here owing to the breadth of the material; instead, the evaluation of each item's historical-linguistic character is left to the specialist reader.

This work is intended primarily as an introductory inquiry – a preliminary step toward a more comprehensive examination of Hittite–Albanian correspondences. Its aim is to identify fundamental lexical and structural parallels and to provide an initial framework for future research. Accordingly, the entries in this lexicon are presented chiefly at the level of Hittite–Albanian semantic and lexical correspondences, without extended phonological or morphological commentary.

A subsequent, more detailed study should ideally focus on assembling a broader corpus of correspondences, thereby demonstrating more systematically – and through a wider range of examples – the proposed phonological shifts and the phonetic laws that emerge from recurrent patterns. Such an analysis could then address the phonological and morphological aspects of the proposed correspondences with greater precision, assessing them according to their degree of plausibility: from strong and reliable to probable, possible, and purely speculative cases, while considering phonological regularity, semantic adaptation, and potential influences or borrowings.

A further stage of research would include reconstruction proposals, incorporating Proto-Indo-European or intermediate forms, accompanied by brief comments on their stability. A

systematic phono-grammatical analysis – encompassing complete paradigms across several root classes – would be essential to clarify the regularities of correspondence and to shed light on both the similarities and divergences between these languages.

In its current form, this lexicon should be regarded as an initial orienting map of significant correspondences, occasionally proposing more speculative connections that might be seen as 'homologic constructions' or 'folk-etymological innovations.'

Ultimately, this entire work is nothing but the tender embodiment of an exploratory dialogue – as ancient as it is contemporary – unfolding between Hittite and Albanian, and extending across the intricate networks of linguistic relations that illuminate the origins and evolution of language itself.

The lexical material for this lexicon is drawn primarily from the Hittite dictionaries of Tischler, Puhvel, and Kloekhorst, always compared with other sources. If, as Melchert has recently noted, these three scholars represent distinct perspectives on Hittite etymology, my approach seeks to maintain methodological consistency and to avoid reproducing their divergences.

I wish to express my deepest gratitude to all colleagues and friends who have stood by me throughout this endeavor. Above all, I am profoundly indebted to Professor H. Craig Melchert (UCLA), the unrivaled Indo-Europeanist and maestro of Hittitology, whose discerning comments, insightful suggestions, and gentle corrections and critiques have been an indispensable guide. Many of his recommendations will no doubt need to find their full realization in future research, a consequence of the exploratory, initiation-like nature of this project and my own limitations in capturing the full measure of his insights.

Naturally, any remaining errors, missteps, or stains are entirely my own.

Paralele hitito-shqipe

Hittite-Albanian Parallels

Mbi lidhjet hitito-shqipe

Ndonëse në gjeografi e kohë të ndryshme, shqipja dhe hititishtja njohën pikëpjekje të dukshme që dëftojnë një trashëgimi të përbashkët indoevropiane, sidomos në fushat fonologjike dhe leksikore. Këto paralele – sado delikate dhe shpesh të errësuara nga mijëvjeçarë zhvillimi më vete – ofrojnë terren premtues për një hetim krahasues. Megjithatë, pavarësisht peshës së tyre të padyshimtë, këto lidhje kanë mbetur mjaft të anashkaluara në studimet gjuhësore shqiptare, ndoshta për shkak të zhvillimeve të vonshme të studimeve hitite, të cilat fituan rëndësi në gjuhësinë indoevropiane vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Pasi u klasifikua përfundimisht si gjuhë indoevropiane, hititishtja mori shpejt një rol qendror në gjuhësinë indo-evropiane, veçanërisht sepse karakteri i saj arkaik sfidoi supozimet e hershme që kishin ngritur sanskritishten si gjuhën më të vjetër dhe më autoritare të familjes indoevropiane. Gjithsesi, hititishtja heq mjaft telashe pas vetes. Dëshmitë e kontakteve të hershme me gjuhë joindoevropiane – veçanërisht me huritishten dhe gjuhët semite – shtojnë shtresa të tjera në profilin e saj historik dhe tipologjik. Nga ana strukturore, hititishtja shfaq tiparet e një gjuhe arkaike indoevropiane: ajo është sa sintetike, me derivate prapashtesash fjalëformuese, po aq eptuese, me shenjues gramatikorë të pjesëve të ligjëratës nëpërmjet një sistemi mbaresash (Hoffner, Melchert 2008, 2).

Kuvendimet e sotme janë përqendruar mbi shkallën në të cilën duhet rishikuar proto-indoevropianishtja që të përfshijë brenda karakterin gjuhësor të anatolishtes, ose, thënë ndryshe, që të përcaktojë se cilat tipare të ‘indo-evropianishtes bërthamë’

(*Restindogermanisch*) përfaqësojnë përnjëmend inovacione të përbashkëta që nuk hasen në anatolisht (Melchert 2017, 194; Rieken 2009; Oettinger 2013–14). Megjithatë, nuk janë vetëm dëshmitë gjuhësore ato që mund të përcaktojnë me siguri nëse hyrja fillestare në Anatoli ndodhi nga veriperëndimi apo verilindja. Ndonëse një hyrje veriperëndimore duket më e mundshme, dëshmitë mbështetëse – siç janë inovacionet e përbashkëta ndërmjet anatolishtes dhe dialekteve perëndimore indoevropiane – mbeten të dëshirueshme (Melchert 2003, 25–26). Gjithnjë brenda këtyre rrymave gjuhësore e kulturore anatoliane dhe veriperëndimore, roli potencial i proto-shqipes, siç reflektohet në ndërveprimin ndërmjet fjalorit të trashëguar shqiptar dhe materialit leksikor hitit, mbetet kompleks dhe i pazgjidhur, por mund të konsiderohet pjesë e një 'imagjinimi dialogjik' gjuhësor më të gjerë, që ndriçon filozofinë historiko-gjuhësore që rri në themel të origjinave indoevropiane.

Nga një këndvështrim krahasues më i hershëm – i cili ndikon gjithashtu në hipotezat mbi vazhdimësinë e proto-shqipes – është besuar gjerësisht që dega anatoliane e familjes indoevropiane, përfshirë hititishten, hyri në Azinë e Vogël nga zonat e Evropës së sotme Juglindore – me shumë gjasë nëpërmjet Bosforit – gjatë mijëvjeçarit të tretë p.e.s. (Watkins 2008, 6). Duke mbështetur këtë lidhje më të gjerë thrako-iliro–anatoliane, gjurmët e emrave ilirë, krahas disa traditave historike, dëftojnë për praninë e grupeve ilire përtej trojeve të tyre të njohura, madje deri në Azinë e Vogël (Wilkes 1996, 39). Brenda këtij kuadri, Vladimir Georgiev propozoi që gjuha pellazge përfaqësonte një fazë kalimtare ndërmjet trakishtes dhe grupit hitit-luvian – e afërt gjuhësisht me të dyja, por identike me asnjërën (1981, 88) – dhe sugjeroi më tej që hititishtja mund të luante një rol kyç në interpretimin e shkrimeve të padeshifruara të Egjeut, përfshirë kretishten (Georgiev 1981, 91). Në frymën e këtij diskutimi, më vonë, Demiraj ngre supozimin se popujt paraindoevropianë të Gadishullit Ilirik e brigjeve të Egjeut nuk i kanë shpëtuar ndi-

kimit nga qytetërimi i lashtë i vendeve të Lindjes së Afërt (Demiraj 2017, 32), një zgjatje e së cilës ishte bërë dikur edhe Perandoria Hitite. Për më tepër, që nga fillimi i shekullit XX, ka zënë vend pikëpamja se ilirishtja përbënte një substrat indoevropian nga i cila më pastaj u shpërfaqën disa degë të peizazhit gjuhësor evropian (Wilkes 1996, 67).

Ndodhi pikërisht në shekullin XX që hititishtja hyri në skenën diturore, shkencore, duke shënuar një kthesë të fortë në studimet indoevropiane. Pas deshifrimit fillestar të Bedřich Hroznýt (1915) dhe interpretimit të tij (1917), njohja dhe studimi i hititishtes si gjuhë indoevropiane njohu disa faza avancimi, duke ndryshuar rrënjësisht konceptimet e mëparshme mbi familjen indoevropiane dhe gjeografinë e saj parahistorike. Kontribute të hershme erdhën nga Forrer (1934) dhe Pokorny (1959), të cilët vunë theksin mbi karakterin indoevropian të hititishtes. Pas Luftës së Dytë Botërore, Hans G. Güterbocku (1997) luajti një rol kyç duke lidhur pikëshikime të vjetra e të reja të studimeve hitite, paralelisht me punën e Bossertit (1947), por nga një këndvështrim tjetër. Në dekadat që pasuan, avancimi mori hov me specialistët kryesorë të anatolishtes si Melchert (1994), Klein, Hawkins dhe Çambel (1999), Tischler (2001, 2016) dhe Kloekhorst (2008). Studime më të veçanta të aspekteve të caktuara të hititishtes u ndërmorën nga Doncel & Lebrun (1983), Puhvel (1984), Van den Hout & Goedegebuure (1980–2019) dhe Yakubovich (2010). Përveç kësaj, indoevropianistë si Lubotsky (1998), Jasanoff (2003), Mallory & Adams (2006), Watkins (2010) dhe të tjerë, trajtuan çështje të tjera, më të gjera, nga aspekti krahasues, duke vendosur hititishten sa brenda vrojtimit të përgjithshëm po aq dhe brenda atij të veçantë në kërkimet indoevropiane.

Peizazhi gjuhësor i të moçmes Lindje të Afërt dhe i Mesdheut Lindor do mund të kapej më lehtë si një seri 'portash', nga njëra te tjetra: nga akadishtja te hititishtja, nga hititishtja te greqishtja dhe nga greqishtja te latinishtja. Perandoritë që përqafuan ose

ndryshuan gjuhët rrallë ishin etnikisht apo gjuhësisht uniforme, dhe konteksti më i gjerë anatolian – që përfshin akadishten, sumerishten, hatishten, hurishten, luvishten, palaishten dhe mitarianishten – pasuroi më tej mozaikun gjuhësor hitit. Edhe kur transmetimi ndodhte në mënyrë të tërthortë, përmes dominimit politik e jo vazhdimësisë etnike, politikat pasuese trashëgonin dhe integronin elemente të traditave gjuhësore të mëparshme. Për rrjedhojë, gjuhët që u zhvilluan pas rënies së perandorisë hitite nuk duhen konsideruar si entitete krejtësisht të reja apo të pavarura. Këtë perspektivë e mbështesin dëshmi që tregojnë se disa grupe etnike që banonin territoret nën kontrollin e Hatushës lanë gjurmë të tërthorta në burimet kuneiforme anatoliane (Yakubovich 2022, 3).

Për më tepër, nuk ka asnjë arsye të mendohet se folësit e luvishtes dhe hurishtes u zhdukën apo u zëvendësuan plotësisht pas rënies së perandorisë hitite. Përkundrazi, Anatolia duhet kuptuar si një udhëkryq gjuhësh dhe kulturash, një urë mes disa botëve të ndryshme (Giusfredi 2023, 2), ku, në fakt "ne thjesht nuk e dimë se cilën/cilat gjuhë përdornin shumica e banorëve të rajonit në jetën e tyre të përditshme" (idem. 106). Konfigurimi i saktë i hapësirës gjuhësore egjeane në kontakt me sferën hitite mbetet i pasigurt, megjithëse frigjishtja del si një nga gjuhët indoevropiane më fort të dëshmuara në peizazhin pas-hitit. Zakonisht, frigjishtja shihet si një gjuhë migratore, e ardhur nga brigjet përballë Egjeut, çfarë vë theksin dhe më shumë mbi kompleksitetin e rrugëve migratore dhe ndërveprimeve rajonale të mëhershme që duhen pasur në konsideratë. Madje, jo rrallë është sugjeruar se në Trojë – *Vilusa* apo *Truvisa* hitite – popullsia vendëse fliste trako-frigjisht, ndërsa trojanët konsideroheshin shpesh pjesë e etnisë trakofrigjiane (Wooduizen 2017), edhe pse ka dëshmi që thonë se popullsia trojane ishte etnikisht heterogjene. Studiues të tjerë, megjithatë, mbajnë qëndrimin se trojanët ishin luvianë dhe se, rrjedhimisht, gjuhë e Trojës ishte luvishtja (Watkins 1986; Bryce 2006; Macqueen 1986). Duke u

nisur nga argumentet që sjell Beekes (2003b), studiuesi Kloekhorst pohon së fundmi aty kah fundi i Epokës së Bronzit, në rajonin lindor të Anatolisë, në Māša, flitej një formë e hershme e lidishtes, ndërsa në zonën perëndimore, veçanërisht në Vilusha, gjuhë dominante ishte proto-tyrenishtja – para-ardhësja e mundshme e etruskishtes (2022a, 201-228).

Këto konfigurime gjuhësore dhe kulturore duhet të kuptohen brenda kontekstit më të gjerë të lëvizjeve të mëdha migratore që karakterizuan fundin e Epokës së Bronzit dhe rrjedhimet e saj në Anatoli, në Egje dhe në territoret e Evropës Juglindore të sotme, duke përfshirë edhe brigjet e Adriatikut.

Në çdo rast, sfondi indoevropian i trako-frigjishtes, luvishtes, lidishtes, proto-tyrenishtes dhe hititishtes, lë të hapur mundësinë që ilirët e lashtë mund të kenë qenë po ashtu pjesë e një identiteti më të gjerë gjuhësor ku hynin edhe trojanët dardanë. Prandaj, ia vlen kujtuar vetë kënga e veçantë, hyrëse, e *Iliadës së Vogël* (sipas *Vita Homeri*), atribuuar Pseudo-Herodotit, me tonin e saj himnizues, tek ia thotë:

> Po i këndoj Ilionit dhe Dardanisë –
> këtij vendi të mëzave bukuroshë,
> ku Danajt – shërbëtorë të Hyut të Luftës - njohën dergjë pa skaj.
> (West 2003, 125)

Këto vargje hyrëse evokojnë një botë në të cilën danajt përballen me vuajtjet që u shkaktohen nga trojanët e Dardanisë, një tokë e lidhur ngushtë me qytetin e Trojës a Ilionit.

Pa dyshim, dardanët përfaqësojnë një pikë kyçe reference për shqyrtimin e ndërveprimeve të hershme thrako-iliro-anatoliane. Ndonëse Homeri e vendos malin Ida pranë Trojës, brenda territorit dardan, etnonimi *Dardani(a)* duket se ka origjinë në rajonin më të gjerë që përfshin Dodonën, Epirin dhe Thesalinë – një zonë që mund të ketë shërbyer si nyje gjeografike dhe kulturore që lidhte Dardaninë ilire (me qendër Kosovën e sotme)

me Dardaninë e Trojadës në Anatolinë veriperëndimore. Autorë klasikë si Straboni dhe Apollodori i lidhin shpesh këto popullsi, duke nënkuptuar një prejardhje të përbashkët apo një lidhje historike të qëndrueshme. Ekzistenca e një qyteti të quajtur *Dardanos* pranë Dardaneleve i jep më shumë peshë kësaj hipoteze. Duke marrë parasysh distancën relativisht të shkurtër ndërmjet rajoneve dardane, nga Kosova e sotme në bregun e Anatolisë së dardanëve trojanë (rreth 600–800 kilometra), një identifikim i tillë duket jo vetëm i mundshëm, por edhe bindës (Papazoglu 1969; Mirdita 1979; Wilkes 1996; Buqinca 2022).

Për më tepër, një këndvështrim arkeologjik, mbi bazën e artefakteve të zbuluara, na thotë se marrëdhënia midis Thrakisë dhe Anatolisë gjatë Epokës së Bronzit na shpërfaq njohuri të vlefshme mbi kontaktet e tyre të ndërsjella dhe, në kuptim të gjerë, dëfton lidhje ndërmjet arealit ballkanik dhe Lindjes së Afërt (Pavúk 2018, 275). Këto marrëdhënie duket se janë shtrirë edhe drejt perëndimit, duke lidhur Anatolinë me Gadishullin Italik.

Në mesin e lëvizjeve të mëdha migratore të popujve dhe gjuhëve, tradita e lashtë e shpjegonte lidhjen ndërmjet këtyre dardanëve transkontinentalë si vijon: Dardani, themeluesi homonim i shtëpisë mbretërore trojane që sundonte mbi disa fise në Azinë e Vogël, konsiderohej përgjegjës për vendosjen e dardanëve në perëndim të thrakasve (Wilkes 1996, 145). Dëshmitë arkeologjike mund të mbështesin më tej mundësinë e vazhdimësive kulturore dhe fetare ndërmjet rajonit dardan dhe traditave më të gjera indoevropiane.

Një artefakt kulti kushtuar *Dea Dardanica*-s, i zbuluar në Kosovën e sotme (Verban, Viti), i datuar në shekujt III–IV të e.s., është interpretuar si dëshmi e një identiteti të qëndrueshëm fetar e kulturor dardan (Shukriu 2014). Kjo hyjni mund të ketë simotrat e veta, si në Azinë e Vogël, ashtu edhe në rajonet e Ilirikut roman, duke sugjeruar ekzistencën e një tradite fetare më të gjerë, mbase ndërajonale, me elemente simbolike e rituale të

përbashkëta (Papazoglu 1969; Mirdita 1979; Stipčević 1989; Buqinca 2022).

Nga një këndvështrim kulturor dhe mitologjik, disa praktika rituale dhe motive simbolike duket se lidhin sferat ilire dhe anatoliane. Përtej traditës së totemizmit të paraardhësve, shembujt si shqiponja dykrerëshe – e konsideruar gjerësisht si simbol totemik i përbashkët – së bashku me disa rite varrimi dhe kulte pjellorie, janë përmendur si dëshmi të strukturave religjioze të trashëguara ose paralele. Ndër më të përmendurat janë kultet ilire të diellit dhe gjarprit, të cilat duket se i bëjnë jehonë simbolizmit religjioz të gjetur në Anatoli (Stipčević 1989). Në mënyrë të veçantë janë tërhequr paralele ngjashmërie me mitin hitit të *Illuyanka*-s, duke sugjeruar që motivet kultike të gjarprit nuk ishin të përhapura vetëm ndër hititë, por mund të jenë ndarë ose përshtatur edhe nga popullsitë ilire. Këto paralele dëftojnë bartjen dhe transformimin e elementeve mitologjike indoevropiane, të mishëruara përbrenda ritualeve të përditshme dhe sistemeve religjioze të këtyre shoqërive të lashta.

Peizazhi politik dhe ushtarak hitit i epokës së bronzit të vonë ofron një kontekst shtesë. Qyteti i Trojës – i njohur në burimet hitite si *Vilusha* – ishte brenda sferës së ndikimit hitit. Sundimtarët vendës, që vepronin shpesh si vasalë, ishin të lidhur me betime formale besnikërie ndaj mbretit hitit dhe kishin për detyrë të mbronin interesat hitite në rajon (Beckman, Bryce dhe Cline 2011, 99–100). Një marrëveshje e rëndësishme ndërmjet perandorit hitit Muvatalli II dhe mbretit të Trojës, e njohur si *Traktati i Alaksandut* (Friedrich 1930; Bryce 2006; Starke 1999), e vendosi Vilushën nën mbrojtjen e perandorisë hitite. Sipas kushteve të këtij traktati, hititët ishin të detyruar të neutralizonin çdo kërcënim të drejtuar kundër Vilushës (Konstantinopoulos 2023, 3).

Gjatë betejës së famshme të Kadeshit (rreth vitit 1274 p.e.s.), dokumentet egjiptiane përmendin qartë dardanët ndër aleatët e koalicionit hitit (Breasted 1906; Matić 2015). Këto dokumente

– veçanërisht *Poema e Pentaurit* dhe *Buletini i Kadeshit* (Hallo, Younger 2003) – dëshmojnë përbërjen shumëkombëshe të ushtrisë hitite. Nëse pranojmë që dardanët e përmendur në këto burime ishin etnikisht ilirë, pjesëmarrja e tyre në një aleancë të tillë forcon hipotezën për ndërveprime të hershme ilire-hitite, jo vetëm në terma ushtarakë, por mbase dhe gjuhësorë e kulturorë.

Sipas Georgievit, grupe si myzët, mygdonët dhe dardanët u shpërngulën nga areali ballkanik në Azinë e Vogël që në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të dytë p.e.s. (1981, 185–186). Kjo ngre një pyetje të rëndësishme historike e gjuhësore: a sollën dardanët me vete një idiomë proto-ilire ose një shqipe të hershme që më pas u ndikua përmes kontaktit me hititishten? Apo ngjashmëritë e vërejtura ndërmjet hititishtes dhe shqipes reflektojnë një substrat më të thellë të paramigrimeve? Që të dy hipotezat janë të mundshme dhe meritojnë shqyrtim të mëtejmë. Në këtë këndvështrim, dardanët mund të kenë funksionuar si ndërmjetës kulturorë e gjuhësorë, duke lidhur Anatolinë me brigjet ish-thrakase-helene-ilire. Megjithëse trajtohen si të ndara në pjesën më të madhe të studimeve moderne, këto rajone shfaqin shenja kontakti dhe traditash të përbashkëta, veçanërisht gjatë epokës së bronzit të vonë.

Nga një këndvështrim gjuhësor, kontakti ndërmjet folësve të hititishtes dhe atyre të proto-shqipes mund të ketë lehtësuar ruajtjen ose transmetimin e disa tipareve arkaike indoevropiane brenda gjuhëve të tyre përkatëse. Georgievi vëren se hititishtja karakterizohet nga një përzierje arkaizmash dhe inovacionesh (1981, 194) – një përshkrim që, me kujdes, mund të shtrihet edhe mbi shqipen. Rritja e numrit të mundshëm të përkimeve fonologjike dhe leksikore ndërmjet hititishtes dhe shqipes na fton për një rishikim të tipareve të trashëguara indoevropiane që mund të reflektojnë shtresa më të thella të vazhdimësisë trako-ilire, përtej afrive e lidhjeve *gjenetike* me anatolishten. Prandaj, këto korrespondenca evidente nuk do duhej keqinterpretuar si dëshmi që shqipja i përket degës anatoliane; më tepër do duhej

marrë si mbetje të tipareve arkaike të përbashkëta, të përhapura dikur gjerësisht ndër dialektet e hershme indoevropiane.

Kjo linjë e kërkimeve përkon edhe me hipoteza të mëparshme, veçanërisht me atë të Norbert Joklit, i cili vinte theksin mbi lidhjen e ngushtë ndërmjet ilirishtes e trakishtes dhe, rrjedhimisht, mbi origjinën e tyre indoevropiane (1929, 278); ndërkohë që u ritheksua edhe ndërlidhja e shqipes me greqishten e armenishten nga Bonfante (1978). Megjithëkëtë, gjuhësia historike shqiptare u ka kushtuar tradicionalisht më shumë rëndësi kontakteve me latinishten, greqishten, sllavishten dhe turqishten (p.sh., Çabej 1986-7; Demiraj 1988; Topalli 2017), ndërsa lidhjet me hititishten kanë mbetur kryesisht të hijezuara. Kjo mund të shpjegohet pjesërisht me inercinë e studimeve të hershme indoevropiane, të cilat për një kohë të gjatë fokusoheshin mbi sanskritishten si modelin kryesor krahasues, dhe vetëm më vonë përfshinë të dhëna nga anatolishtja në kornizën e kërkimeve të gjera indoevropiane.

Punimi aktual synon të rihapë çështjen e korrespondencave të mundshme ndërmjet hititishtes dhe shqipes – qoftë gjuhësore, kulturore apo historike – me synim rishikimin e supozimeve të heshtura brenda gjuhësisë historike indoevropiane. Kjo analizë nis nga hipoteza se disa tipare leksikore dhe strukturore të përbashkëta në këto gjuhë nuk janë rastësore, por tregojnë procese historike më të thella që ende nuk janë kuptuar plotësisht. Duke vepruar kështu, ajo sfidon klasifikimet rigjide brenda familjes indoevropiane dhe kërkon një rishikim të mënyrës se si janë vendosur kufijtë gjuhësorë në raport me kohën dhe hapësirën.

Ndërkohë që hititishtja, si një gjuhë anatoliane, dhe shqipja, që përfaqëson degën e saj të pavarur, ndodhen në skaje të ndryshme të spektrit indoevropian, ekzistenca e elementeve leksikore të përbashkëta ndërmjet tyre nuk mund të injorohet. O qenë rrjedhojë e trashëgimisë nga një paraardhës i përbashkët, o i një kontakt-areali gjeografik, o zhvillime paralele - ato

thërrasin për shqyrtim të mëtejmë. Ky punim shprush mundësinë që ngjashmëritë e vërejtura mund të burojnë ose nga një fazë e hershme divergjence gjuhësore, ose nga episode të mëvonshme kontakti ndërmjet bashkësive folëse të (proto)hititishtes dhe proto-shqipes. Në të dyja rastet, implikimet janë të rëndësishme: ato sugjerojnë ndërveprime historike dhe prekje gjeografike që kanë mbetur të ekslipsuara në studimet tradicionale indo-evropiane. Kapitujt pasues sheshojnë këtë hipotezë, nëpërmjet një analize sistematike të paralelizmave leksikorë, të korrespondencave fonologjike dhe kontakteve të mundshme, me synimin më të gjerë për të bërë një hap në të kuptuarit e mëtejmë të gjuhëve indoevropiane dhe ndërveprimeve gjuhësore parahistorike.

Ndërrimet fonologjike hitite–shqipe

Me të nisur duhet theksuar se identifikimi i korrespondencave fonologjike midis shqipes dhe hititishtes paraqet goxha sfidë për rivlerësimin e shqipes arkaike. Madje, këto korrespondenca, shpesh vënë në dyshim disa skema të ndryshimeve fonetike tashmë të kthyera në tradicionale, si hamendësime që shquajnë zhvillimin nga PIE te proto-shqipja (PAlb), ndaj në disa raste, edhe zhvillimet e brendshme nga PAlb te Shqipja Klasike duhet riparë me kujdes (shih Orel 1998; 2000).

Nëse arritja e Hrozný-t, n'atë zeman, qëndronte në zbatimin e metodave kombinatorike dhe etimologjike – në përputhje me shumicën e praktikave për analizimin e korpuseve gjuhësore të reja, vetëm pjesërisht të kuptuara (Melchert 2015, 259) – atëherë qasja ime e këtushme mund të kuptohet si një paralele e qëllimshme, si një përpjekje për të 'imituar' metodën e tij për kapjen e korrespondencave hitito–shqipe. Në këtë kuptim, kam synuar të 'ribëj' shqipen në raport me sistemin fonologjik hitit – duke 'inventuar', deri diku, një proto-shqipe jo-standarde. Sepse, edhe nëse mund të flitet sadokudo për një fazë të

përcaktuar të proto-shqipes, ajo mbetet një fushë e hapur ndaj dyshimeve, supozimeve e hetimeve, që mund të shtrihen nga Meyeri (1891) te Oreli (1998) e këndej.

Sistemi shkrimor kuneiform hittit është fort kompleks, me kombinimin e silabogrameve me sumerograme, të shoqëruar shpesh nga komplementë fonetikë hititë (Melchert 1994; Kimball 1999; Kloekhorst 2008). Shkrimi lexohet nga e djathta në të majtë, me hapësira midis fjalëve, ndonëse enklitikët u ngjiten drejtpërdrejt fjalëve paraprake. Shumë shenja kuneiforme janë 'polifonike', të afta për të përfaqësuar mjaft vlera fonetike (Melchert 2023, 2), çfarë ndërlikon edhe më përpjekjet për të shpërfaqur me saktësi format hitite në shqip.

Vendosja e korrespondencave midis tingujve ose shkronjave hitite dhe shqipe është veçanërisht sfiduese, sepse fjalët hitite zakonisht fillojnë me vetëm 14 shkronja të veçanta nistore, ndërsa shqipja tregon një inventar më të pasur zanoresh dhe bashkëtingëlloresh në fillim të fjalës. Për të zgjidhur këtë dallim, shpesh është aplikuar një shkallë e 'adaptimit protetik' nëpërmjet futjes së tingujve nistorë. Edhe pse këto ndërfutje a ndërkallje fonologjike mund të duken fonetikisht të parregullta, ato justifikohen kur vërehet se kthimi i rindërtimeve iniciale ose 'amputimeve' provizionale i bën rrënjët e shumë fjalëve hitite të korrespondojnë ngushtë me homologet e tyre në shqip. Është treguar kujdes që ky protetizëm të mos i orientojë korrespondencat shqipe drejt inventimeve folk-etimologjike, sa të përfaqësojë një përpjekje metodologjikisht të mbështetur për të kapur korrespondencat fonologjike arkaike, duke reflektuar të paktën zhvillime paralele, nëse jo përkime të njëmendta.

Brenda kontekstit më të gjerë indoevropian, shqipja – sado që shumë e re *me letra* – shpërfaq një zhvillim karakteristik fonetik. Reflekset e saj manifestojnë palatalizim të fortë, zëshmëri e lenizim të stopaleve dorsale, veçan para zanoreve frontale dhe nazaleve. Krahasuar me format më konservatore hitite, këto reflekse shfaqin dy prirje përplotësuese: hititishtja ruan një

sistem dorsal të hershëm dhe të pandryshuar, ndërsa shqipja demonstron një prirje përshtatëse frontale dhe aspiratave, me bazë analogjike. Pra, bien në sy:

- palatalizimi velar para zanoreve frontale: *k* → *q / ç / shk*;
- lenizimi ose aspirimi i stopaleve të zëshme: *g / gh* → *h*;
- zhvillimet protetike te shumë rrënjë fjalësh;
- alternimet e zëshme në grupe labiale dhe dentale: *p* ↔ *b, t* ↔ *th*.

Semantikisht, korrespondencat përqendrohen rreth fushave të veprimtarisë bazike, të jetës së përditshme në shoqëri e në natyrë, të farefisnisë dhe praktikave rituale, duke treguar stabilitet të hetueshëm diakronik.

Tabela vijuese ofron një bërthamë përfaqësuese të korpusit më të gjerë të korrespondencave hitito–shqipe, duke ilustruar rregullsi të qarta fonetike dhe semantike. Këto përkime dëftojnë se si rrënjët hitite, të shfaqura shpesh në kontekste rituale, agrare e shtëpiake, janë ruajtur, transformuar ase riinterpretuar në shqip.

hititisht	**shqip**	**kuptimi**	**korrespondencat fon.-morfol.**
ad-/et-	ha(je)	to eat; food	*h* protetike; *a* > e ruajtur; humbja e –*d*-së në fund
app-	kap	to take, seize	*k* protetike; ruajtje e mbylltores
atta-	ati	father	ruajtja e rrënjvs *at*-; stabilitet i zanores
ehu-	eja	come!	*h* > *j* lenizim; vazhdimësi vokale
ek-	dek	to die	*d* protetike

hititisht	**shqip**	**kuptimi**	**korrespondencat fon.-morfol.**
			para rrënjës me zanore fillestare
damass-	dëmtoj	to damage, harm	ruajtje e rrënjës *dam-*; rregullsi vokale
kata-	këtu, këtej	here, alongside	*a* > *ë*; *k* e ruajtur; përdorim deiktik i qëndrueshëm
kanes-	njoh	to know	*k* > *nj*, *a* > *o*, *-nes* > *-h*
karu	herët	early, before	*k* e ruajtur; *a* > *e*; *r* e ruajtur
katan-	ketanë, këtej	alongside	*k* > *k*; *a* > *ë*; deiktik lokativ i ruajtur
kalmi-	e kallur	firewood, log	rrënja *kal-* e ruajtur
karp-	kap	to seize	humbja e *r*-së; ruhet *k* dhe plozivja fundore
karas-	korr	to cut, reap	*a* > *o*; asimilimi i *r*-së; *k* e ruajtur
karawar-	grurë	grain, harvest	*k* > *g* asimilim; reduktim i *a*-së
kalluwai	kallje/kallur	bright, burning	*-ll-* e ruajtur; semantika dritë/ zjarr
gurg-	gur	stone	humbja e *-g-s*ë në fund; qëndrueshmëri e zanores
kukus-	kërkoj	to seek, try	*k* e ruajtur; *u* > *e/ë* në format derivuese

hititisht	**shqip**	**kuptimi**	**korrespondencat fon.-morfol.**
kappa-	kepa/qepa	onion	*a* > *e*; thjeshtimi i geminantes *pp* > *p*
kappila-	kapem	to seize, fight	*k* e ruajtur; labialja mbylltore e ruajtur
hastai/hasti-	asht/heshtë	bone/spear	*h* protetike; *s* > *sh*; zgjerim semantik
happzi-	kap/ngjis	to attach, join	*h* > *k* refleks; qëndrueshmëri e a-së
hat-	thati/thaj	dry, to dry	*h* > *th*; zhvendosje aspirimi
hattari(a)a-	shata; shati	hoe, prick, awl	*h-* > *sh-*, *-tt-* > *-t-*, *-ari-* > *-a/-i*
kaddu-	kthetra	talons, claws	*k-* > *k-*, *-dd-* > *th-* spirantizim
hatrai	thotë/thërret	to speak, call	*h* > *th*; *t* > *th* alternim
hāwi-/hawes-	dhi/dhenë	sheep, goat	*h* > *dh*; lenizim dhe deaspirim
hassa-	gaca/vatër	ember, hearth	*h* > *gh* > *g*; *ss* > *c*
heyu-	shiu	rain	*h* > *sh*; *e* > *i*
gakaessar-	kafshar	to bite	*gk* > *kf*; metatezë
gahari-	hajë/haj	bread/to eat	*gh* > *h*; përshtatje vokale
ganu-	gju/gju(ri)	knee	*g* e ruajtur; humbje nazale
lai-	la/lëshoj	to release, free	rrënja *lai-* e ruajtur; reduktim diftongu
lak-	lakoj	to bend	rrënja stabile; *a* e ruajtur; *f*

hititisht	**shqip**	**kuptimi**	**korrespondencat fon.-morfol.**
			protetike
lukki/a	flakoj/vë flakën	to light	rrënja stabile; *a* e ruajtur; *f* protetike
laksais	floksajë	to set fire	rrënja stabile; *a* e ruajtur; *f* protetike
pai-/pa-	jap, paguaj	to give, to pay	*p* e ruajtur; *d* > *j* në format derivuese
palla-	shpaloj	to unfold, spread	*p* > *shp*; *a* e ruajtur
pakkuss-	pakësoj	to reduce, crush	rrënja *pak*- e ruajtur
pap(a)-	baba/apa	father	*p* > *b*; reduplikim
paprahh-	papastër	impure, dirty	*p* e ruajtur; morfologji reduplikative
mallai-	bluaj/mulli	to grind; flour	*m* e ruajtur; ndërrim vokal
malit	mjaltë	honey	*m* e ruajtur; *a* > *ja* palatalizim
marri	(i) marri/ë	rash, foolish	*r* e dyfishuar; vazhdimësi semantike
man-	mund/mbaj	to hold, govern	*m* e ruajtur; nazale e ruajtur
massiya-	mesore/rrip	belt, middle	*s* e ruajtur; *a* > *e*
sakuwai	shoh/shikoj	to see	*s* > *sh*; ngjyrosje e zanores
sap-/ sapai-	cop(ë)toj	to grate, peel	*s*- > *c*-; *a* > *o*; sufiks -*t*-
sannai	shuaj	to extinguish	*s* > *sh*; asimilim nazal; *a* > *u*
tapari	(të) prij, i parë	to lead	*t* e humbur; -*pari* i ruajtur/ modifikuar

hititisht	**shqip**	**kuptimi**	**korrespondencat fon.-morfol.**
dala-	dal/lë	to go out, leave	rrënja *dal-* e ruajtur; zgjerim semantik
dankui	zhdukur	disappeared	*d* > *zh*; humbje nazale; zh negacion
danna	dhana/jap	to give/take	*d* > *dh*; alternim stop/frikativ
alel	lule	flower	*l* e ruajtur; *e* > *u*
summumahhi	shumohem	to copulate, pair	*s* > *sh*; asimilim nazal; *a* > *o*
ans/anas	anash/anësor	aside, lateral	rrënja *an-* e ruajtur
ais/iss-	haish/gojë	mouth	*s* > *h/sh*; zanore protetike
kus	kush	who	*k* e ruajtur; zanore u e qëndrueshme
kuer/kuwar	shkurt(oj)	to cut	*s(h)-* protetik; rrënja *-kur-* e ruajtur
karu	herët	early, former	*k* e ruajtur; *a* > *e*
turahi-	thurës, thurje	stake, fence	*t* > *th*; *r* e ruajtur
tarman	tharm/burim	source, ferment	*t* > *th*; nazale e ruajtur

Korrespondencat midis hititishtes dhe shqipes, që mund të vërehen edhe këtu, zbulojnë një ndërthurje komplekse procesesh fonologjike, morfologjike dhe semantike.

Seria velare dëshmon për palatalizim të shpeshtë në shqipe (*k* → *q/ç/shk*), shpesh të shoqëruar me metatezë në leksikun agrar dhe atë të përditshëm, shtëpiak (p.sh. *karawar* → *grurë*). Aspirantet e zëshme dhe dorsalet (*g/gh*) pësojnë lenizim të rregullt në *h***,** ndërsa shumë tema që fillojnë me *h* marrin zanore ose bashkëtingëllore protetike për të përmbushur strukturën rrokjesore dhe gjedhen morfofonemike të shqipes.

Stopalet labiale dhe dentale zakonisht ruajnë identitetin e tyre, por shpesh shpërfaqin alternime zëshmërie ose spirantizim, ta zëmë, në termat e farefisnisë ose në kontekste derivacionale (p.sh. *palla* → *shpaloj*; *pap(a)-* → *baba*). Nazalet dhe likuidet mbeten në thelb të pandryshuara, por shpesh riorganizohen përmes futjes së zanoreve ose thjeshtimit të grupeve bashkëtingëllore (p.sh. *man-* → *mund*; *karas* → *korr*). Në mënyrë të ngjashme, prapashtesat denomative si *-t-* (p.sh. *sapai-* → *cop(ë)toj***)** shënojnë derivim morfologjik në bashkëveprim me fonologjinë e trashëguar.

Këto modele në tërësi vënë në pah një perspektivë të dyfishtë brenda kornizës indoevropiane: hititishtja ruan një sistem konservativ të bashkëtingëlloreve dorsale dhe plozive, ndërsa shqipja pasqyron zhvillime më të vona fonetike, duke përfshirë frontalet, lenizimin dhe përshtatjen me bazë analogjike. Pavarësisht këtyre divergjencave fonetike, vazhdimësia semantike mbetet e theksuar, sidomos në fushat që lidhen me jetën e përditshme, ritualet dhe farefisninë. Kjo sugjeron që shqipja nuk i trashëgoi rrënjët hitite vetëm në nivel fonetik, por ndërmori një riaranzhim interpretativ e përshtatës, duke ruajtur kuptimin kulturor dhe leksikor krahas reflekseve që dalin nga evolucioni i vet fonologjik.

Thënë përgjithësisht, evidencat na flasin për një evolucion plotësues fonetik të shqipes në raport me hititishten, duke dëshmuar njëkohësisht trashëgimi sistematike dhe inovacion specifik gjuhësor, si dhe duke ofruar një këndvështrim të nuancuar mbi dinamikat e hershme indoevropiane.

Kompleksiteti i korrespondencave fonologjike shpesh kërkon rindërtime të përputhshme për të plotësuar boshllëqet që burojnë nga inventari i kufizuar fonologjik i hititishtes ose nga bashkëtingëlloret nistore të pasigurta në shqip, të cilat, siç u tha më lart, shpesh shfaqen si shtojca protetike.

Këto imputime janë veçanërisht të rëndomta në pozicion fillestar të fjalës, ndonëse ndodhin ndonjëherë edhe brenda

rrënjëve. Fjalët hitite që fillojnë me *i-*, *is-*, etj. (zakonisht zanore, por ndonjëherë edhe bashkëtingëllore) shpesh korrespondojnë në shqip me forma që kanë bashkëtingëllore protetike – *s(h)-, j-, h-, g-, rr-, p-, n-, m-, l-, ose z-* – duke reflektuar përshtatje të nevojshme fonotaktike. Ky model shtrihet në fusha semantike që përfshijnë folje veprimi, mjete fizike dhe koncepte sociale apo juridike, duke treguar vazhdimësi të fortë semantike krahas inovacionit fonologjik. Rindërtimet e këtij lloji duhen parë me kujdes, pasi mund të devijojnë nga modelet standarde që rrjedhin nga linja: PIE → proto-shqipe → shqipe moderne (Topalli 2017; Orel 1998).

Brenda kësaj kornize, perspektiva krahasuese me shtresën anatoliane rezulton veçanërisht e vlefshme për fonetikën historike të shqipes. Kur shqyrtohen përmes sistemit fonologjik hitit, korrespondencat ndriçojnë ndërveprime të ndërlikuara midis dy gjuhëve. Prandaj përpjekja e këtushme, sado e kujdesshme, kërkon të shtrojë elementet themelore të korrespondencave, përderisa, në të njëjtën kohë, shpesh është një shkallë pasigurie sa i përket vlerës fonetike të saktë të një foneme hitite në raport me homologen e saj në shqip.

Numri relativisht i vogël i fonemave, veçanërisht i grafemave hitite – zakonisht rreth katërmbëdhjetë – ka kërkuar shpesh një masë rindërtimi dhe interpretimi për të mbushur boshllëqet leksikore dhe kapur pikëprerjet e formave hitite me ato shqipe.

Prania e elementeve laringale në shqip, u propozua për herë të parë nga Hamp (1965, 123–141), i cili argumentoi se PIE $*h_4$, që sipas tij ngjyrosi $*e > *a$, por u zhduk në hititisht, mbijetoi në shqip si *h-*. Ndonëse ky interpretim u vu më vonë në diskutim nga Ölberg (1972, 121–135), hipoteza e Hampit mbetet e rëndësishme si një nga përpjekjet e para sistematike për të gjurmuar reflekset e drejtpërdrejta të laringaleve indoevropiane në shqip. Në dritën e sprovave të fundme krahasuese, duket me vlerë të rishqyrtohet çështja e *h*-së në shqip përmes një krahasimi sistematik me hititishten, ku reflektimet laringale ruhen qartë.

Po aq të rëndësishme janë vëzhgimet e Kortlandtit mbi reflektimet e përbashkëta armeno-shqipe të **sw-*së PIE dhe reduktimin e tyre të hershëm monofonematik, si edhe komentet e tij mbi reflektimet e laringaleve në këto gjuhë (1986, 44). Kortlandt vuri re se shqipja ruan vazhdime të qarta të PIE-ve **h₂e-*, **h₃e-*, **ho-*, **h₃-* në shumë leksema që përputhen me shembujt hititë, përfshirë:

> *hap* 'hap' < **h₂oḱ-*; *hinj* < **h₂eu-*; *hut* < **h₂eut-*; *hip-* < **heup-* ; *herdhe* < **h₃erǵh-*; *ha* < **h₂eu-*; *ardhur* < **h₁orǵh-un-*; *athët* (ndoshta *hidhur*) < **h₂oḱ-*; *ah-* < **h₃os-*; *asht* < *h₂rh₃-* etj.
>
> (1986: 44–45).

Këta shembuj tregojnë se elementi laringal, ndonëse shpesh i reduktuar ose i asimiluar, duket se ka lënë gjurmë në fonologjinë e shqipes, veçanërisht si aspirim nistor ose si ngjyrosje zanoresh, paralel me atë çfarë dëshmohet në hititisht.

Trajtimi i laringaleve në hititisht dhe shqip tregon si dallime, ashtu edhe vazhdimësi të thellë strukturore. Vërtet, në shumë fjalë shqipe, laringalja është zhdukur, por në disa raste, reflekset e saj janë evidente (Hamp 1965). Herë pas here, *ḫ*-ja fillestare hitite korrespondon me bashkëtingëllore velare shqiptare, si në *halzai-* ↔ *kallxoj/ kallzai* 'tregoj', duke sugjeruar një zhvillim *h- > k-/g-* në rrethana të veçanta fonetike. Pavarësisht qëndrueshmërisë relative të *ḫ*-së hitite, korrespondencat e saj shqipe janë të ndërliqshme dhe varen nga konteksti, duke e bërë të vështirë formulizimin përbrenda një ligji të vetëm fonetik.

Sido që të jetë, korrespondencat e qëndrueshme – si ato fillestare (*ḫ- > h-*) ashtu edhe ato të mesme (*-ḫ- > -h-, -hh-* apo *zero*) – dëftojnë për një model të përbashkët strukturor. Afërsia e *ḫ*-së hitite dhe *h*-së shqiptare shfaqet më shpesh në fushat semantike që lidhen me hapjen, shfaqjen, thyerjen, goditjen, tërheqjen dhe veprimin ritual – fusha që zakonisht shënohen nga laringalet në PIE. Dallimi midis *h*-së të trashëguar dhe asaj protetike mbetet vendimtare për përcaktimin e përkimësisë së vërtetë.

Korrespondenca mes hit. *ed-, ad-* ‘të hajë’ ↔ shq. *ha, haje* ‘ha, ushqim’, reflekton formën PIE **h₁éd-ti/ h₁d-énti* ‘të hajë’. Po kështu, anat. *edriyea-* ‘ushqej’ dhe shq. *heti* ‘ushqej, jap ushqim’, kanë bazë të përbashkët nga **h₁ed-ri-* (Kloekhorst 2008, 262–263). Një shembull tjetër i mundshëm është përputhja mes hit. *karu(ili)* ‘i hershëm, i mëparshëm, i lashtë’ ↔ shq. *herët, i hershëm* – e ndryshme nga shq. *herë* ‘kohë, orë’ (< lat. *hora*) – e cila mund të vazhdojë formën PIE **ǵʰreh₁-u-* ‘i hershëm, përpara (në kohë),’ me përkime si ON *gryiandi* ‘agim’, OHG *grao* ‘gri’ dhe sued. *dagen gryr* ‘dita agon’. Me gjasë, shq. *herët* përfaqëson një formë të reduktuar të **ǵʰerh₁u-*, në të cilën aspirantja palatale fillestare ǵʰ- ka humbur, ndërsa laringalja pasuese *h₁* ka dhënë *h*-në e sipërfaqshme. Kështu, forma shqipe mund të ruajë refleksin e laringalit, por jo të stopales nistore, ndryshe nga hit. *karu-* që ruan refleksin e deaspiruar të *ǵʰ*-së.

Rasti më domethënës është hit. *ḫastai/ ḫasti* ‘kockë’ (< PIE *h₃esth₁-i*), që fitoi kuptimin figurativ ‘forcë’, ruajtur te *ḫastili-* ‘trim, heroik’. I njëjti zgjerim semantik shfaqet në **s**hq. *asht* ‘kockë’ dhe *heshtar* ‘trim, luftëtar’, me alternim karakteristik *a:e*. *H*-ja inciale, në të dy rastet, mund të ruajë gjurmën e një laringaleje të trashëguar. Ngjashëm, hit. *ḫestaless-* ‘të bëhesh trim’ përkon semantikisht me shq. *(të bëhesh) heshtar* ‘(të bëhesh) trim, luftëtar’. Kështu, *heshtë/ heshtar* duket se nuk rrjedh nga *hell* ‘pjek, skuq’ (Meyer 1891; Jokl 1911; Topalli 2017), por nga e njëjta rrënjë si *asht*, duke vazhduar një metaforë arkaike indoevropiane që lidh ‘kockën’ me ‘forcën’. Lat. *os* ‘kockë’ presupozon një *e*-gradë (**h₃est-*), skt. *asth-* reflekton **h₃estH-*, ndërsa gr. *ὀστέον* < **h₃esth₁-ei-* ngjet fare me hit. *ḫaštai* < **h₃esth₁-oi*, siç vëren Kloekhorst (2008, 325).

Raste të tjera, si shq. *hap* dhe *gjah* (Topalli 2017, 585), mund të ruajnë aspiranten fundore arkaike, siç shihet te *gjah/ gjahtar*. Hit. *huit-* ‘gjuaj, qëlloj’ dhe *huittiya-* ‘gjueti’ sjellin PIE **gʷeh₃-* ose **iagh-*, duke sugjeruar mbijetesën e një rrënje të laringalizuar në të dy degët.

Zhvillime paralele mund të vërehen në forma si hit. *huuapp(i)/ hupp-* ↔ shq. *hap, hedh, hudh, hup***;** hit. *huk-, hukis-* 'ma-gjepsje' ↔ shq. *hukis, hukamë* dhe hit. *palahh-* 'thërras' (< *pleh₂-*) ↔ shq. *leh, pall*. Këta shembuj dëftojnë një aspirim ose velarizim të rregullt të kushtëzuar nga laringalet, duke ruajtur gjurmë fonetike PIE.

Korrespondencat e përsëritura fonetike sugjerojnë që *ḫ*-ja hitite përputhet me *h-*, *g-*, ose *gj-* të shqipes, varësisht nga rrethanat fonetike. Sado të pareduktueshme në një ligj të vetëm fonetik, këto ndërrime shpërfaqin reflekse të shtresuara, të formësuara nga konteksti kronologjik, morfologjik e fonotaktik. Për shembull, *ḫ*-ja protetike ose e trashëguar mund të përkojë me *gj*-në para zanoreve të përparme (*huis-* → *gjuej*). Ndërsa palatalizimi sekondar ose velarizimi (*gj-* → *ç-/q-/ k-*) e ndërlikon edhe më tej pamjen.

Ngado që ta marrësh, të dhënat mbështesin hipotezën e Hampit (1965) që laringalet PIE mbijetojnë në shqip si bashkëtingëllore të aspiruara, sado që të shprehura ndryshe nga hititishtja. Pavarësisht ristrukturimeve të thella fonologjike në shqip (si bjerrja eptuese, reduktimet vokale, ndërrimet konsonantike) ato ruajnë gjurmë të shtresave më të vjetra indoevropiane, të shpërfaqura nëpërmjet krahasimit me anatolishten. Hititishja, si dega më e hershme e atestuar indoevropiane, ofron çelësa për të kuptuar këto reflekse të shqipes. Këto gjuhë, që të dyja, ndonëse të ndara në kohë dhe hapësirë, ruajnë ngjashmëri të habitshme në sjelljen fonetike dhe në gjedhet semantike, veçanërisht sa i përket ruajtjes së aspirimit të kushtëzuar nga laringalet dhe semantikës metaforike midis qëndrueshmërisë fizike dhe forcës morale a heroike.

Vetë trajtimi i elementit laringal ilustron ndërliqësinë e sistemit fonologjik të shqipes, si në formën e tij moderne, ashtu edhe në stadet e supozuara të moteve të hershme. Shqipja duket se ka zhvilluar një spektër më të gjerë e më dinamik fonemik sesa ai që reflektohet në hititisht. Veçanërisht, shfaqja e shpeshtë

e bashkëtingëlloreve protetike në pozicion fillestar – shpesh për të plotësuar boshllëqe fonetike e ruajtur përkimësinë semantike – dëfton për një proces aktiv të kompensimit fonologjik.

Një shembull i qartë i kësaj prirjeje shihet në zhvillimin e *f-së protetike:

lukki/a- ↔ *flakia* > *flakoj, ndez* 'të ndez, vë flakën';
laksais- ↔ *floksai-* > *floksajë* 'gjilpërë argjendi, karficë';
lala- ↔ *fjala/la-la* 'gjuhë, të folur, (onom.)'.

Në rastin e fundit, korrespondenca *l:fj* (*lala-* ↔ *fjala*) është spekulative, por edhe pse e paatestuar si ndryshim fonetik, ajo bëhet e besueshme, tipologjikisht e semantikisht brenda një vokabulari onomatopeik dhe ekspresiv.

Në të vërtetë, shqipja shpesh krijon grupin bashkëtingëllor *fj-* nëpërmjet shtesës protetike të *f-së para sonoranteve, dhe *fjala* mund të ruajë një formë më të hershme, si *fala* ose *lala*, që nënkupton 'të folur, gjuhë', derivat ky i mundshëm nga një zhvillim më i vjetër me temë në *-s* (*sp-/ps-* > *f-*) në pozitë nistore, si reflektim i një forme protoshqipe **spela* (Orel 2000, 95). Kjo mund të vërehet ende nga aor. *fola*/ *foli*, (e përdorur në disa kohë madje, në të dy dialektet, sikur dhe në standard). Kështu, ngjashmëria ndërmjet *lala-* dhe *fjala-* duket se reflekton një formim konvergjent ekspresiv para se trashëgimi të drejtpërdrejtë fonetike.

Raste të tjera të ngjashme të korrespondencave semantike të qarta, por fonologjikisht jo të rregullta (p.sh. kalimi i *l*-së në *m-* apo *d*-së, në disa forma shprehëse), provon më tej se edhe devijime të tilla, sado që pa rregullsi fonologjike sistematike, mund të ruajnë vazhdimësi domethënëse semantike.

Sa i përket funksionit të thjeshtë protetik, *f*-ja fillestare e një sërë fjalësh që fillojnë me grupe bashkëtingëllore duket të jetë zhvilluar si një element më i vonshëm, duke prodhuar grupe të reja bashkëtingëllore. Kjo vërehet në fjalët si *fletë*, *flutur*, *fluskë*,

flatër, *flegër* e forma të tjera të ngjashme. Zhvillime të përafërta, me një shkallë pothuajse të njëjtë dendurie, janë dëshmuar edhe me bashkëtingëllore të tjera në pozitë fillestare, si *s*-, *k*- dhe *m*-.

Nga ana tjetër, kemi edhe raste ku shqipja tregon aferezë të një laringaleje nistore, si në formën e trashëguar nga PIE *h_1*nómn̥* 'emen/ emër':

laman- ↔ *(a)man* > *emën/ emër*

Do vënë re se në raste të tjera, *l*-ja ruhet plotësisht si element paratheksor i rrënjës semantike, duke shfaqur pothuajse përkimësi perfekte mes dy gjuhësh:

lant- ↔ *(e)lanët/ (e)lënë*;
le- ↔ *le/ lëre!* 'mos, lëre!'

Duhet vënë re se, në rastet kur bashkëtingëllorja fillestare paraqitet si *s-, k-, m-, d-,* ose si ndonjë element tjetër protetik, motivimi i saj fonetik nuk është gjithnjë menjëherë i qartë.

Megjithatë, përmbajtja semantike e fjalës përcakton në mënyrë të qëndrueshme kuptimin e saj, pavarësisht nga çdo tingull fillestar i shtuar ose i ndryshuar. Për shembull, karakteri i prefiksit negativ protetik si *s*- (= nuk) mund të marrë formë tjetër morfo-leksikore dhe të shprehet përmes një formimi të përbërë ose frazor të fjalës, qoftë në hititisht qoftë në shqip:

paranalla- ↔ *paranal(t)ë* 'ballkon; platformë, pengesë'

Pra, *paranalla* merr kuptim qoftë të *ndalesës*, qoftë të platformës apo ballkonit lart. Ndërkohë, *s-/sh-* shfaqet si parashtesë e mëvonshme në shqip:

patatti- '(me) këmbë' ↔ *shputas* 'me shputa';
piddai- ↔ *shpejtoj, nxitoj*.

Ose si parashtesë k-:

pussai- ‘copëtoj, shtyp’ ↔ *[k]pusai* > *këpus; rrëzoj* ‘thyej, copëtoj’.

Ndërkaq, *s*-ja shpesh korrespondon me *g, s, q, z, t, gj,* etj., pasi në disa raste fonema hitite përfshin spektër më të gjerë fonemik të shqipes:

sarip-/sarap- ↔ *garp* > *gjerb*, rrufis;
suhha-i/suhh- ↔ *guai/gjuh-* > *gjuaj*, hedh, derdh; shtie; shuhem;
senahha- ↔ *zenaka-* > *zën(ë)ka/zënka*; gracka;
sallan(n)ai- ↔ *qallonai* > *qëlloj*, godas;
simisiyanu- ↔ *timosian-* > *tymosja*, tymos ‘timos’.

Në tri rastet e para, ndryshimet janë thjesht fonetike dhe nuk përfshijnë protezë, ndryshe nga shembujt që pasojnë. Njëkohësisht, vërehet një përputhje e qartë ndërmjet formave të përbëra dhe atyre analitike, si dhe ndërmjet shprehjeve idiomatike, siç ilustrohet më poshtë:

sawitist- ↔ *(sa)-viti* > *sa-viti*, *vjetor,* motak;
witantatar ↔ *vitin-(te)-tar* > *(të) tërë/ tarë vitin*;
appa parza ↔ *prapa-parza* > *prapa*, mbrapsht, së prapthi;
para parza ↔ *para-parza* > *përpara*.

Këtu, si forma fonetike ashtu edhe përmbajtja semantike ruhen plotësisht.

Në mënyrë të ngjashme, në disa rrethana, ndalesat *t-ja* dhe *d-ja* kanë njohur aspirimin, duke dhënë frikativet *th* [θ] dhe *dh* [ð], zhvillim ky karakteristik i fonologjisë historike të shqipes:

taye/ a-zi ↔ *thyej*, vjedh;
tar- ↔ *tir* > *thirr, thërras*;
das-/ dask- ‘marr’ ↔ *das-* > *dhashë* < *jap/dhâ*.

Natyra supletive e foljes shqipe *jap* është e njohur, por krahasimi i *dhashë* me hititishten *da* meriton vëmendje të veçantë, për shkak të kompleksitetit të tij fonologjik dhe morfologjik.

Përtej korrespondencave konsonantike, një veçori mjaft domethënëse dhe e rregullt është ndryshimi sistematik i vlerave vokale ndërmjet hititishtes dhe shqipes, veçanërisht korrespondenca e *-a-s*ë ndërkonsonantike hitite me *-e-n*ë shqipe. Kjo korrespondencë vërtetohet në forma foljore, emërore dhe mbiemërore, siç ilustrohet në shembujt vijues:

hallaniya- ↔ *qellan-* > *qëllon,* godet, shkallmon;
hallu- ↔ *thallu* > *i/e thelluar i thellë*;
irhatt- ↔ *raht/reth* > *radhë, rresht, rreth*.

Thënë përmbledhurazi, hititishtja dhe shqipja shpërfaqin korrespondenca të qarta midis formës fonetike dhe përmbajtjes semantike, siç dëshmohet nga shembujt e dhënë më sipër. Rastet që përfshijnë ndryshime fillestare ose protezë zbulojnë më tej modele sistematike: *laksais-* ↔ *floksajë* 'fibulë argjendi' (me *f-*protezë); *markiya-* ↔ *shmang/ s'marr* 'shmang, refuzoj' (me *s/sh*-protezë), dhe *pussai-* ↔ Alb. *këpus* (me *k*-protezë).

Po kështu, *lant-* ↔ *lanë/ lënë* tregon përputhje fonetike e semantike, ndërsa *le-* ↔ *le, lëre* tregon përdorim paralel të urdhërores, pavarësisht debatit të vazhdueshëm mbi formën hitite.

Format e përbëra dhe frazat, si *paranalla-* ↔ *paranaltë* 'ballkon, pengesë, platformë', ruajnë korrespondenca fonologjike e semantike, duke theksuar lidhjet e strukturuara hititisht-shqip, si në nivelin leksikor ashtu edhe në atë gramatikor. Korrespondenca të tjera ndjekin trajektore fonetike të dallueshme: *sarip-/sarap-* ↔ *gjerb* 'pij me gllënjkë, gëlltis'; *senahha-* ↔ *zënkë, kurth, grackë*; *suhha-i/suhh-* ↔ *gjuaj, shuaj/shuhem*.

Ndonëse mospërputhje të caktuara fonetike mbeten të pazgjidhura, dëshmitë e ofruara dëftojnë për korrespondenca të

qarta fonetike e semantike midis hititishtes dhe shqipes, duke nxjerrë në pah modele të qëndrueshme të protezës, fjalëformimit dhe konservimeve semantike që shkojnë përtej rastësisë.

Paralele morfo–semantike

Ndonëse janë identifikuar qartë raste korrespondencash fonetike ndërmjet hititishtes dhe shqipes, janë përkimet morfo-semantike ato që kanë rëndësi të dorës së parë për rindërtimin e shtresave më të thella të kuptimeve të përbashkëta, me peshë, për ndriçimin e aspekteve të veçanta strukturore të proto–indoevropianishtes, të tilla siç shpërfaqen në epokën e bronzit.

Morfo-semantika hitite, e ndërlidhur ngushtë me sistemin e saj fonologjik, ofron një dritare fare të veçantë e të qartë drejt origjinave dhe zhvillimeve të proto–indoevropianishtes. Ruajtja e strukturave gramatikore dhe gjedheve semantike arkaike – shpeshherë më konservatore se në pjesën më të madhe të gjuhëve të tjera të lashta indoevropiane – siguron njohuri themelore për evolucionin e morfologjisë dhe kuptimeve proto-indoevropiane (Hoffner & Melchert 2008; Kloekhorst 2022; Rieken 1996; Pokorny 1959).

Përderisa paralelet fonetike, si të vetme, rrallë shpjegojnë qëndrueshmërinë e kategorive konceptuale e funksionale, qasja e këtushme integron dëshmitë fonologjike me zhvillimet semantike, me morfologjinë derivacionale dhe me kontekstin më të gjerë kulturor e ritual. Ky kuadër i kombinuar tejkalon kufijtë e analizës tradicionale leksikostatistike ose thjesht fonologjike, duke mundësuar identifikimin e shtresave të trashëguara që mund të zbulojnë formime arkaike indoevropiane, përndryshe të eklipsuara nga inovacionet e mëvonshme.

Brenda këtij këndvështrimi, dëshmitë tregojnë gjithnjë e më shumë se shqipja ruan një substrat të konsiderueshëm të fjalorit dhe të modeleve morfologjike arkaike indoevropiane, që shfaqin afërsi të dukshme me ato të anatolishtes, veçanërisht me

strukturat leksikore dhe semantike të hititishtes (krh. Mann 1977; Orel 1998, 2000; Çabej 1986–87).

Ndër gjuhët moderne indoevropiane, shqipja dhe lituanishtja duket se paraqesin numrin më të madh të korrespondencave me hititishten. Kjo, me shumë gjasë, reflekton ruajtjen e veçorive të veçanta arkaike nga ato, duke ofruar njohuri të çmuara për strukturën e gjuhës së hershme indoevropiane dhe për degëzimet e saj anatolike (Orel 1998). Këto përputhje nuk duhen interpretuar si dëshmi të trashëgimisë së drejtpërdrejtë nga hititishtja në shqip. Për më tepër, korrespondencat janë tregues që të dyja këto gjuhë ruajnë elemente të një substrati të hershëm indoevropian. As shqipja dhe as lituanishtja nuk janë pasardhëse të drejtpërdrejta të anatolishtes, sado që të dyja ruajnë tipare arkaike indoevropiane që janë zhdukur në pjesën më të madhe të gjuhëve të tjera moderne.

Nga ana tjetër, sado që hititishtja dhe shqipja janë strukturalisht të ndryshme – shqipja i përket degës perëndimore indoevropiane, ndërsa hititishtja linjës anatolike – ato ndajnë një numër të konsiderueshëm njësish leksikore në fusha semantike themelore, si bujqësia, pjesët e trupit dhe jeta e përditshme. Këto përputhje, me gjasë, pasqyrojnë kontakte të hershme ose bashkëjetesë përbrenda një mjedisi të përbashkët gjuhësor indoevropian, në përputhje me modelet hibride të shpërndarjes së PIE dhe të ndërveprimit kulturor e gjuhësor gjatë neolitit dhe epokës së bronzit (Heggarty et *al*. 2023).

Studimet e mëparshme shpesh e kanë përjashtuar shqipen nga ky kontekst. Përderisa autorë si Puhvel (1988) dhe Melchert (2017) kanë vërejtur paralele midis anatolishtes dhe degëve perëndimore si greqishtja, keltishtja e gjuhët italike, rrallë ka ndodhur që shqipja të përfshihet në këto diskutime, duke i dhënë asaj shpesh një status ‘jo-dëshmues’ për rindërtimin e indo-evropianishtes së hershme. Megjithatë, vëzhgimet e hershme nga Mann (1977) e ndonjë tjetër kanë hetuar lidhje fonologjike e morfologjike ende të pa-eksploruara midis hititishtes dhe shqipes.

Duke u mbështetur në shembujt e korpusit të shqyrtuar, hititishtja dhe shqipja, pavarësisht ndryshimeve strukturore, ruajnë veçori konservatore të fjalorit dhe të gramatikës indoevropiane, secila në mënyrë të vet. Shqipja ruan një sistem të plotë foljor që përfshin gjashtë deri në shtatë mënyra – përfshirë forma të habitores e dëshirores – të cilat, ndonëse të rralla ndër gjuhët moderne indoevropiane, reflektojnë dallime modale të pranishme në fazat e hershme PIE (Newmark 1982; Çabej 1986–87). Hititishtja, nga ana e saj, ruan një sistem të fuqishëm të kategorisë së rasës dhe morfologjisë së eptimit, duke konservuar forma që janë zhdukur në shumicën e degëve të tjera indoevropiane (Beekes 2011).

Ndërkaq, sa u përket strukturave sintaksore të këtyre dy gjuhëve, ato ndryshojnë: hititishtja paraqet rendin tipik të lashtë SOV, ndërsa shqipja ndjek rendin më modern SVO. Shqipja gjithashtu përdor nyje të caktuara dhe të pacaktuara, çfarë mungojnë në hititisht dhe në pjesën më të madhe të gjuhëve të lashta indoevropiane. Kjo e bën shqipen strukturalisht inovative, por leksikalisht konservatore – një paradoks që thekson pozitën e saj unike brenda gjuhësisë historike indoevropiane (Hamp 2007; Mann 1977).

Në këtë pikë, është e nevojshme të theksohet çështja e parashtesave në shqip, e cila në shumë aspekte mbetet e paqartë, pasi kufijtë ndërmjet formimit parashtesor dhe atij aglutinativ nuk janë gjithnjë të përcaktuar qartë (Xhuvani & Çabej 1956: 66–103). Prandaj shpesh është e vështirë të përcaktohet nëse format si *f-, m-, te-, de-,* dhe *sper-* rrjedhin nga origjina të pavarura që kontribuojnë në proceset e derivimit të brendshëm, apo nëse ato janë zhvilluar si elemente parashtesore që funksionojnë kryesisht si përforcues brenda sistemit foljor ose emëror. Një numër i konsiderueshëm formimesh foljore, mbiemërore, parafjalore dhe idiomatike të këtij lloji e mjegullon edhe më tej kuptimin e saktë të mekanizmave të formimit të fjalëve në shqipe. Krahasuar me hititishten, formime të tilla shpesh

tregojnë ngjashmëri formale, por zhvillim semantik të ndryshëm; rrjedhimisht, ngjashmëritë e vërejtura midis dy gjuhëve mund të përfaqësojnë vetëm homologji sipërfaqësore dhe jo tregues të trashëgimisë së përbashkët. Këto raste zbulojnë jo vetëm afritë, por edhe divergjencat fonosemantike që karakterizojnë marrëdhënien midis shqipes dhe hititishtes.

Të marra së bashku, këto venerime i japin mbështetje hipotezës se hititishtja dhe shqipja nuk ndajnë një lidhje gjenetike të drejtpërdrejtë, por pasqyrojnë ndërveprim të thellë historik brenda një zone proto–indoevropiane kontakti. Prandaj, përkimet leksikore të vërejtura mund të shpjegohen në terma të ruajtjes paralele të kontakteve të hershme ose të përhapjes së përbashkët areale. Brenda këtij kuadri, shqipja del si një dëshmitare thelbësore e shtresave të nënpërfaqësuara të para-historisë indoevropiane, veçanërisht sa i përket ndërlidhjes së saj me grupin anatolik të gjuhëve.

Një shqyrtim i sistemit foljor të *hititishtes* na shpërfaq dallime të rëndësishme midis *anatolishte*s dhe gjuhëve të tjera të lashta indoevropiane si greqishtja dhe sanskritishtja. Në përgjithësi, folja hitite karakterizohet nga format e saj të së tashmes dhe preteritit të dëftores, si dhe nga prania e një klase etimonesh 'të thjeshta' tematike, të ndërtuara drejtpërdrejt nga rrënjët (si te Lat. *ferō,* Gr. *phérō,* Skt. *bhára*-). Për më tepër, ka arsye të mira për të besuar se hititishtja (dhe anatolishtja në përgjithësi) ka pasur dikur mënyrat lidhore dhe dëshirore (Hoffner & Melchert 2008).

Nga kjo pikëpamje, hititishtja dhe shqipja ndryshojnë ndjeshëm në sistemet e tyre të mënyrave foljore. Po të krahasohet me mesapishten, shqipja (e hershme) duket se ka pasur të paktën katër mënyra (Mani 2004), tipar ky që, me gjasë, ka pasur rrjedhimet e veta për rendin e fjalëve dhe për vetë fleksibilitetin sintaksor. Edhe pse morfologjia e sistemit foljor të shqipes përputhet më ngushtë me atë të greqishtes dhe sanskritishtes, përbërësi i saj leksikor duket se ruan lidhje të thella me hittitishten.

Sido që të jetë, paralele interesante midis hititishtes dhe shqipes bien në sy sa i përket formimit të temave të së tashmes dhe të aoristit. Foljet hitite të zgjedhimit me *-hi*, të cilat kanë pak afri të drejtpërdrejta me degë të tjera indoevropiane, zbulojnë disa prirje strukturore ndaj formimeve shqipe. Po kështu, sistemi foljor në shqip shfaq një konfigurim *rrënjë–mbaresë* që të kujton modelet morfologjike të hititishtes dhe kjo ndodh veçanërisht në dialektin gegë të shqipes. Mbaresa e vetës së parë njëjës në kohën e tashme në shqip, *-j,* rrjedh historikisht nga *-i-ja*, siç dëshmohet në forma si *shkoj* < *shkoi*, ose në variante arkaike e dialektore me *-i*, p.sh. *ap(i)/jap(i)* 'jap', korresponduese me hit. *pai-/ piya-ḫi*; ose '*dha(j) < dha(i): jap'*, i krahasueshëm me hit. *dai-/ di-ḫi* 'marr'; ose *kapi* 'kap' që korrespondon me hit. *kap-ḫi*. Për më tepër, aoristi në vetën e tretë njëjës në shqip ruan *-i-* në arkaike, siç shihet në formime supletive si *dhai/ dhajti (> standard: dha)*.

Në këtë linjë, paradigma hitite *pai-/piya-* 'jap' i afrohet ngushtë asaj të *dai-/tiya-* 'vendos, vë' < *PIE *dhe-* (Puhvel 2011: 56), që korrespondon si në aspektin semantik, ashtu dhe në atë morfologjik me shqipen *ap(i)/jap* dhe *dhâ*, duke shpërfaqur afri kuptimore e gramatikore. Këto pikëpjekje formale dhe funksionale sugjerojnë sa konvergjencë tipologjike, po aq edhe mundësi të ruajtjes së një trashëgimie morfologjike të përbashkët brenda kuadrit më të gjerë indoevropian.

Një paralele tjetër nga dëftorja, e tashme, veta e tretë, jepet nga nga hit. *nai* 'ai/ajo udhëheq' (krh.: *skt. nāyati* 'ai/ajo udhëheq'), që korrespondon me shqipen dialektore *nais/nis* 'ai/ ajo niset, udhëheq'. Në preterit, hit. *nais* 'ai/ajo udhëhoqi' korrespondon me shqipen *(u) nis* 'ai/ajo u nis, udhëhoqi'. Prapashtesa shqipe *-s* mund të reflektojë ruajtjen e një treguesi të hershëm aoristi indoevropian, të krahasueshëm me funksionin e tij në PIE të vonë, siç vëren Strunk (1994). Kjo përputhje tregon se si shqipja ruan sa rrënjë leksikore po aq edhe tregues aspektualë që përputhen me format hitite, duke nxjerrë në pah vazhdimësi të

thella morfo-semantike brenda sistemit foljor indoevropian.

Një veçori tjetër e rëndësishme është përputhja midis prapashtesës së pjesores hitite *-ant-* (Oettinger 2014, 156–157) dhe prapashtesës së pjesores në shqip *-on/-an-*. Shembujt përfshijnë hit. *dai-ant-* 'duke dhanë/ dhënë' ↔ *alb. dhan(ë)*; kështu, gjedhet hitite përkojnë me format shqipe *lon(ë)/ lan(ë), thonë/than(ë), zan(ë)* etj.

Sa i përket morfologjisë nominale, zakonisht sanskritishtja shërben si pikë reference me tetë rasa, tri gjini dhe tre numra, ndërsa shumica e gjuhëve të tjera të hershme indoevropiane – lënë anash disa forma baltike dhe tokariane – përdorin një sistem më të reduktuar. Shqipja ruan rasat emërore, kallëzore, gjinore, dhanore, thirrore dhe rrjedhore. Hititishtja, përkundrazi, ruan një sistem nominal të thjeshtuar në raport me PIE, duke mbajtur të paktën funksionet e rasës emërore, kallëzore, gjinore, dhanore/ lokative dhe rrjedhore/instrumentale, ndërsa humb në masë të madhe dallimet gjinore gramatikore. Ky reduktim përputhet me mesapishten parashqipe, e cila gjithashtu duket se ka mungesa sa i përket formës femërore (Mani 2024). Shqipja më vonë e riktheu dallimin gjinor, me risi të tilla si *ai-o* > *ajo*, ku femërorja shënohet me prapashtesën *-o*.

Huazimet leksikore

Që të dyja, shqipja dhe hititishtja përfshijnë huazime jo të pakta – shqipja nga latinishtja, greqishtja dhe turqishtja, ndërsa hititishtja nga akadishtja dhe gjuhët fqinje anatolike. Megjithatë, këto ndikime prekin kryesisht leksikun por nuk reflektojnë ndryshime të vërejtshme në gramatikën bazë.

Në hititisht hetohen qartë terma të huazuar, por sistemi emëror e foljor, sintaksa dhe leksiku bazë mbeten të burimit indoevropian, të përforcuar nga logogramet që ruajnë format e trashëguara përmes një mekanizmi të brendshëm shkrimor. Fare ngjashëm, huazimet e shqipes pasurojnë fjalorin, por fonologjia, morfologjia dhe sintaksa ruajnë tipare të trashëguara. Së këndejmi, në të dy gjuhët, elementet e huazuara e plotësojnë, por nuk e ndryshojnë kornizën gramatikore dhe morfo-semantike që përbën bazën e krahasimit historik.

Përderisa huazimet latine janë parë tradicionalisht si ndikimi kryesor i jashtëm në shqip, nga krahasimet që mund të shihen tashmë midis hititishtes dhe shqipes na dalin sugjerime që afirmojnë rivlerësimet. Disa fjalë që më parë janë konsideruar si latine – dhe ndonjëherë të përbashkëta me greqishten – mund të përfaqësojnë ndikime të mëvonshme paralele, ndërsa format shqipe mund të ruajnë struktura të trashëguara nga indo-evropianishtja e përbashkët. Këto interpretime fonosemantike mbeten ende në fazë eksperimentale dhe implikimet e tyre gramatikore kërkojnë shqyrtim të kujdesshëm përpara se të nxirren përfundime të qëndrueshme.

Të marrim, për shembull, hit. *upati* me shq. *pata-* → *pasuri/ pasanik* ‘patja < pasuri, pronë, zotërim; njeri i pasur’; krh. po ashtu me luv. *upatit(i)* ‘pasuri, pronë, zotërim’ (Tischler 2016, 400; Kloekhorst 2008, 923). Ky zhvillim, me gjasë rrjedh nga PIE **pótis* ‘zot, burrë, pronar’, me një zgjerim semantik të shfaqur në luv. *u-pa* ‘pajis, dhuroj’ (Melchert 1993, 242), që në shqip ilustron kalimin nga koncepti i zotërimit dhe autoritetit te ai i pasurisë.

Kjo rrënjë nxjerr në pah autoritetin përmes zotërimit, një koncept i pasqyruar në hierarkitë familjare, hyjnore dhe publike. Format krahasuese përfshijnë skt. *pati*, gr. *πόσις*, hit. *pati*, av. *paiti*, lat. *possideo* dhe lit. *pàts*. Afërsitë semantike si skt. *dhanapati* 'zot i pasurisë,' gr. *πότνιος ἀνήρ* 'burrë zotni/ zotnues' me shq. *dhan-pati, njeri/ zot pasunie; pasanik*, tregojnë se zotërimi dhe pasuria japin konceptet themelore sa i përket konceptualizimit të autoritetit, pavarësisht ndryshimeve të vogla fonologjike. Në shqip, *pata/ pasanik* (që mund të ketë evoluar në *zot/ni*) reflekton një kornizë të qëndrueshme indoevropiane, duke kthyer *zotërimin* në thelb të konceptit të *posedimit/ patjes*, përtej një huazimi latin.

Korrespondenca të tjera vërehen edhe në terminologjinë që lidhen me trupin apo funksione fiziologjike. Hit./gr./lat. *sehuri-/ οὖρον/ urina* 'urinë' – ndonëse, ndonjëherë, u atribuohen rrënjëve të ndryshme – përkojnë me shq. *shurrë* dhe derivatet e saj *shurroj, pëshurrës, shurrnik*, duke ruajtur struktura arkaike morfo-fonemike dhe një leksik të trashëguar nga tradita indoevropiane:

sehuriya ↔ *shurroj* 'urinoj';
hurnai- / hurnuwai- ↔ *shurrnoj / spërkas* 'spërkas, lag';
hāppessar-/ happittala- ↔ *pëshurrës* 'penis, organ mashkullor'.

Forma *sehuri(ya)* ruan bashkëtingëlloren nistore *s-* dhe një strukturë rrënjore të përbërë, që mungon në gr. *οὖρον* dhe lat. *urina*. Këto të fundit rrjedhin rregullisht nga rrënjë indoevropiane, kryesisht nga një rrënjë e vetme; megjithatë, forma greke, sipas Beekes (2010, 1128–1129), lidhet me **uors-e-o-*, e reflektuar në skt. *varsati* 'bie shi', ndërsa lat. *urina*, sipas tij, kthehet te **uh₁-r-*, që përkon, ndër të tjera, me skt. *var-* 'ujë'.

Nga ana tjetër, *sehuri-* duket se pasqyron një formim më të vjetër; PIE **seh₂ur* (Eichner 1973, 69–70; Oettinger 1979; Rieken 1999; Kimball 1999) ose ndoshta **seikwr*, duket e afërt

me OHG *seihhen* ‘urinoj’. Si *sehuri-* ashtu edhe *dur/ dun* ‘urinë; fekalie’ duket se zbresin nga shtresa palaike ose para-luviane (Kloekhorst 2008, 899), para se të jenë huazime semitike (krh. Kortlandt 2004, 11).

Folja shqipe *shurroj* ofron mbështetje shtesë për këtë interpretim. Fjala *shurrë*, me ruajtjen e nistores *sh-* (që mund të trajtohet edhe si refleks prefiksi) dhe me geminanten e brendshme *-rr-*, shpërfaq modelin arkaik morfo-fonemik të *sehuri*-t hitit. Ruajtja e bashkëtingëllores *s-* e bën korrespondencën hitito–shqipe fort me shêj, duke dëftuar një formim të përbashkët sub-PIE ose pas-PIE të hershëm dhe duke nxjerrë në pah karakterin konservator të shqipes brenda kontinuitetit indoevropian. Kjo përputhje tregon se shqipja, mu si hititishtja, ruan një shtresë morfologjike të lashtë të **seh₂ur*, që u paraprin thjeshtimeve që prodhuan *urina* dhe *οὖρον* në latinisht e greqisht.

Të tjera korrespondenca na dalin gjithandej në leksema që emërtojnë mjete, mbajtëse, kapëse e lidhëse, duke treguar vazhdimësi semantike dhe fonologjike; e tillë është hit. *hapti-*, që gjen rezonancë të padyshimtë me shq. *hapëse/ kapëse* ‘kapëse flokësh, gjilpërë lidhëse, karficë’.

Ndonëse bashkëtingëllorja nistore *h-* në hititisht rëndomë nuk pritet të reflektojë një *k-* indoevropiane (Melchert 2015), mbase në disa situata dialektore ose kontakti gjuhësor – ndoshta nën ndikimin egjean ose fqinjësor – mund të ketë ndodhur një ngjyrosje ose afrim i pjesshëm midis *h-s*ë dhe *k-s*ë, që ka lënë gjurmë në reflekse të mëvonshme. Në këtë drejtim, shqipja mund të ruajë mbetje fonetike ose semantike nga këto fenomene kontakti.

Disa përkime të tjera hitito–shqipe sugjerojnë gjithashtu mbijetesën e një baze morfologjike arkaike, ku elemente si geminantet labiale *-pp-* dhe zgjatimet instrumentale si *-i-, -ta-,* shënojnë funksione të kapjes, lidhjes ose fiksimit. Këto forma duken të lidhura semantikisht dhe morfologjikisht me rrënjën

PIE *_kap-_ ‘të kapësh, të mbash’, të dëshmuar gjerësisht në gjuhët indoevropiane: krh. gr. *κάρφι* ‘gozhdë’, gr. mod. *καρφίτσα* ‘kapëse, karficë’ dhe lat. *cāpere* ‘kap’.

Në shqip, *kap-* dhe *hap-* shpërfaqin një ndërveprim interesant semantik; ato mund të japin emra mjetesh që shërbejnë për kapje ose shtrëngim (*kapëse = hapëse*; darë, pincë, pincetë). Ndryshe nga latinishtja, e cila priret kah një përqëndrueshmëri më stabile e modelit foljor, shqipja duket se ruan një vazhdimësi të gjerë semantike të tipit egjean, ku veprimet e *marrjes*, *hapjes* dhe *lidhjes* mbeten konceptualisht të ndërthurura. Kjo sugjeron që *kap-* dhe *hap-* mund të kenë bashkëjetuar dikur brenda një fushe të përbashkët morfologjike e semantike, duke ruajtur jehona të një shtrese më të lashtë, ndoshta paraindoevropiane ose të lindur nga kontakti.

Për më tepër, në shqip, kjo rrënjë mbetet produktive si për formime foljore ashtu edhe emërore (*kap, kapëse; hap, hapëse*), dhe përputhja e funksioneve të saj me serinë hitite *hapti-* dëfton për një fushë të përbashkët semantike të kapjes, lidhjes dhe mbajtjes. Dyfishimi i labiales *-p(p-)* i ndjekur nga zanorja e parme, e zëshme, *-i-,* mund të pasqyrojë një formim të dyfishtë ose intensiv në hititisht, përderisa në shqip, sekuenca të ngjashme shpesh rezultojnë me reflekse të përqendruara në *ë/e* përmes reduktimit të zanoreve në rrokje të patheksuara – një prirje fonetike kjo në pajtim me leksikun e trashëguar.

Shqipja gjithashtu dëshmon konservimin dhe inovimin e rrënjëve hitite që shpesh asociojnë me ato latine e greke. Për shembull, fjala *vërshoj* i atribuohet zakonisht lat. *verso/ versare*, por produktiviteti i saj derivacional reflekton më shumë modelet hitite:

warsa- ↔ *vërshim, shi i madh*
Derivate:
warsini/a- ↔ *vërshimi*;
warsula- ↔ *i/e vërshuar*;

warsulas sanizzis- ↔ *vërshujë*;
wars-/warsiya- ↔ *vërtis*;
[LUV]*wār-/warsa* ↔ *vërshim.*

Nga rrënja *ver(s)-*, e cila më vonë mori formë parashtese, shqipja derivoi fjalët *vërshim*, *vërsulem*, *vërtis*, *vrik*, *vrull*, e ndonjë tjetër, që dëshmojnë një sistem fjalëformues produktiv dhe semantikisht të qëndrueshëm, të krahasueshëm me paradigmën hitite. Është e mundshme që rrënja të ketë qenë fillimisht e lidhur me nocionin e 'ujit; rrjedhës' < luv. *warsa* 'ujë' (Melchert 1994), me formimet me *vërshim*, si zhvillime semantike sekondare.

Në mënyrë të ngjashme, hit. *kurur-* mund të shfaqë përputhje semantike dhe më pak fonologjike me shq. *urrej, urryer, urrejtës, urrejtje*, fjalë që mund të shpërfaqin një rrjet leksikor të trashëguar, të lidhur me armiqësi, kundërshti dhe mospëlqim. Origjina e saktë etimologjike e këtyre formave mbetet për t'u kuvenduar. Një ngjashmëri sipërfaqësore me lat. *horreō, horrēre* 'dridhem, rrëqethem' sugjeron një fushë semantike të përbashkët të ndjesisë së neverisë, ndonëse korrespondenca fonologjike (*h-* kundrejt *u-*) duket problematike.

Një shpjegim më bindës, sipas Puhvelit (1984: 286), e lidh *kurur-* me gr. *θήρ* (*thḗr*) 'bishë e egër'; sllav. vjet. *zvěrь*; lit. *žvėrìs* dhe lat. *ferus* 'i egër', të gjitha rrjedhime nga PIE **g[w]her-/ghwer-* 'i egër, i pazbutur'. Një fushë semantike e afërt, megjithëse rrjedhur nga një rrënjë tjetër, përfaqësohet nga hit. *hurt-/ huwart-* 'mallkoj, fyej, poshtëroj', që përputhet me shq. *urrej(t).* Po ashtu, hit. *hurtali-/ hurtalimma-* 'armik, kundërshtar' gjen një paralele në shq. *urryer(i)* 'i urryer, armik'.

Në këtë kuptim, *kurur-* shpreh ndjenjën e egërsisë apo të zemërimit, konceptualisht të lidhur me armiqësi emocionale. Kjo rrënjë pasqyrohet gjithashtu në shq. *(i) egër*, që korrespondon semantikisht – sado që më pak fonetikisht – me *urrej*, duke sugjeruar se *urrej* mund të përfaqësojë një zhvillim të

mëvonshëm shprehës ose denominativ brenda së njëjtës fushë semantike të agresionit dhe armiqësisë, para se një përkim të drejtpërdrejtë të *kurur*.

Sa i përket termit tjetër hitit, *kaliss-* 'thërras', ai korrespondon me lat. *clamāre* dhe gr. *καλεῖν*, të gjitha nga rrënja PIE **kel-* 'thërras, shpall'. Formimet shqipe *kluaj/ kluoj/ klai* → *quaj, thërras, kaj/ qaj, klith* japin palatalizimin e bashkëtingëllores nistore *k-* para zanoreve të parme, ndërkohë që disa grupe bashkëtingëllore (*kl-, gl-*) ruhen (p.sh. *klisha, gluha*), duke reflektuar shtresime dialektore dhe thellësi kronologjike (Bonnet 1998, 216). Një nocion tjetër, i konsideruar me origjinë të ngjashme, është:

hummant- 'i tërë, i plotë': *^{s}huma-* > *shumë/ shuma,* e gjitha, e tëra, secila.

Lat. *summa* 'shuma, tërësia e pjesëve', korrespondon me kuptimin formal në shqip, ndërsa kuptimi më i gjerë i shqipes *shumë* – i përdorur si ndajfolje ose përemër – lidhet me lat. *totus, omnis* 'i tërë, çdo'. Shqipja duket se ka ruajtur vetëm një refleks të vonë të aspiruar nga latinishtja në bashkëtingëlloren nistore *sh-*. Fonetikisht, nuk ka përputhje të drejtpërdrejtë; *h-*ja hitite duket të jetë palatalizuar në *sh*-në e shqipes.

Fjala hitite *hummant-* 'i tërë, i plotë, çdo' përputhet semantikisht me kuptimin në shqip të *shumë,* më gjerësisht sesa me lat. *summa* 'shumë, krejt, majë', që është më abstrakte dhe letrare, e prejardhur nga PIE **som-*/*sómos* → *summus*, me *s-* të trashëguar drejtpërdrejt. Ndonëse lidhje të mundshme janë vërejtur (Tischler 1983: 284–285), *shumë* duket më afër rrënjës hitite, ndoshta duke reflektuar një shenjë të shkurtër laringale të *h-s*ë hitite, edhe pse kjo gjasë ka më shumë leksikore sesa që përbën standard ndërrimi fonologjik. Ngjashmëria homonimike me lat. *summa* në kuptimin 'tërësi' përfaqëson një ndikim të mëvonshëm latin, të dallueshëm nga zhvillimi i trashëguar i tipit hitit *hummant-* → *shumë*.

Ndikimi i huazimeve sllave në shqipe rezulton, në mjaft raste, më i ndërlikuar sesa është supozuar tradicionalisht. Për shembull, hit. *zakkini* 'person i ligjit' dhe *saklai* 'ligj' shfaqin përputhje të dukshme semantike me sllav. *zakon* 'ligj' dhe shq. *zakon* 'ligj zakonor', ky i fundit shpesh i interpretuar si huazim sllav.

zakkini-/ sakkinni- ↔ *zakontar/ zakonor* 'administrator; person ligji';
saklai-/ sakli-/ sakkai- ↔ *zakon*, traditë zakonore, ligj.

Një venerim më i hollë na sugjeron që këto formime mund të reflektojnë shtresa të trashëguara leksikore dhe konceptuale më tepër sesa huazime të thjeshta. Ndërsa *zakkini-* duket të jetë një huazim nga akadishtja dhe *saklai-* një term vendës hitit, në dukje i lidhur me lat. *sacer*, të dyja shprehin nocione të shenjtërisë dhe hyjnores, duke funksionuar si atribute mbrojtëse ose zbatuese të ligjit dhe të normave zakonore. Nga pikëpamja semantike, ato formojnë një vazhdimësi që rezonon me *zakon*-in e mëvonshëm në të drejtën zakonore shqiptare dhe sllave, duke ilustruar ndërthurjen e qëndrueshme ndërmjet autoritetit të shenjtë dhe atij juridik.

Edhe pse *zakoni* shqiptar shfaq përshtatje fonologjike konsistente me formën e ndërmjetme sllave, konceptet e tij themelore administrative, juridike dhe ndëshkimore duken të rrënjosura në një substrat më të lashtë indoevropian, çfarë sugjeron që shqipja mund të ketë konservuar dhe riaktivizuar një kornizë semantike parasllave, e cila më vonë u përforcua dhe modifikua përmes kontaktit me sllavishten. Një zhvillim i ngjashëm mund të ketë ndodhur në fushën e së drejtës sa i përket një koncepti themelor: fjala hitt. *hanna-i/ hann-/ hannessar* (f.) 'padis; gjykoj; ndaj drejtësi' korrespondon semantikisht me shqipen *kanun* dhe shprehjen *daj kanun*; *gjykoj me kanun*.

Përderisa *kanuni* shqiptar është lidhur tradicionalisht me gr. *κανών* 'ligj, rregull, shkop matës', ai mund të ruajë në vete një

konceptim më të lashtë indoevropian të së drejtës. Hitt. *hanna-i* ofron një paralelizëm semantik të ngjashëm. Edhe pse tingulli fillestar *h-* në hititisht nuk korrespondon rregullisht me *k-*në PIE dhe për rrjedhojë nuk mund të barazohet drejtpërdrejt në mënyrë fonologjike me *k-*në e greqishtes apo të shqipes, është e mundshme që në këtë rast të kemi pasur një zhvillim individual ose areal që do të ketë dhënë *h-* nga një *k-* më e hershme ose nga një rrënjë e afërt. Prandaj, lidhja ndërmjet hit. *hanna-i* dhe shq. *kanun* e gr. *κανών*, duket më bindëse në nivel të vazhdimësisë konceptuale dhe semantike sesa nga ana e korrespondencës së rreptë fonologjike. Së këndejmi, propozimi për përkimet: gr. *κανών*, shq. *kanun*, ka njëfarë besueshmërie përderisa ato reflektojnë nocione *gjykimi* e *përgjegjësie*.

Një rivlerësim i ngjashëm mund të provohet edhe për çiftin tjetër hititisht–shqip *ḫasira-* ↔ *k(h)osire*. Edhe pse *kosë*, në përgjithësi konsiderohet si huazim sllav, morfologjia dhe semantika e saj lidhen më bindshëm me rrënjën PIE **kes-, *kos-* 'korr, pres, godis', një pikëpamje kjo e papranueshme për studiuesin Derksen (2008, 238). Kjo rrënjë është gjerësisht e dëshmuar në gjuhët indoevropiane (krh. me skr. *śastra-* 'thikë, armë', gr. *κείρω* 'pres, qeth', lat. *caedere* 'pres' dhe italo-kelt. *costra* 'teh') dhe në shqipe ruhet jo vetëm te *kosë/ kosire* dhe në zvogëlimin *kosëz*, por edhe në foljen bazike dhe me spektër të gjerë fjalëformues *korr*, si dhe në emrat *korrje*, *korrës*.

Megjithëkëtë, përkimi i propozuar ndërmjet *ḫasira-* dhe *k(h)osire* duket jo i besueshëm dhe mbetet i pasigurt, sidomos duke pasur parasysh që *ḫ-ja* fillestare te *ḫasira-* palaike/ hitite nuk mund të rrjedhë nga PIE *k-* (Melchert 1994). Sidoqoftë, nëse *ḫasira-* është me prejardhje jo-hitite, ajo mund të pasqyrojë një formim më të lashtë, ndoshta para-anatolian apo anatoliano–egjean, që do të sugjeronte një izoglosë areale të trashëguar e jo një huazim të mëvonshëm leksikor. Prandaj, hipotetikisht, shqipja mund të ketë ruajtur kështu një vazhdimësi autentike të temës arkaike **kas-*/ *kos-*, të integruar në sistemin e saj foljor

dhe në leksikun vendës të veglave. Kjo do të dëftonte mbijetesën e një shtrese të thellë leksikore të përbashkët me hititishten dhe, më gjerë, me vetë substratin protoindoevropian.

Modele të ngjashme mund të vërehen te koncepti hitit *wartanna-* që korrespondon me shq. *vërtitje* 'rrotullim, qark, kthesë' dhe me sllav. *vrviti* 'rrotulloj, sjell, kthej/ kthehem'. Kjo korrespondencë zvogëlon domosdonë e shpjegimit përmes skr. *vártis*, duke shënjuar më shumë kah një strukturë e përbashkët, e trashëguar. Shqipja ruan po ashtu formime produktive numerike të të njëjtit tip:

aikawartanna ↔ *nai*/*një-vërtitje*;
terawartanna ↔ *tri-vërtitje*;
sattawartanna ↔ *shtatë-vërtitje*;
nawartanna/i ↔ *nantë-vërtitje*.

Fjalët nga këta shembuj lidhen fillimisht me terma të stërvitjes së kuajve, nga Kikkuli dhe kanë hyrë nëpërmjet hurritëve nga sanskritishtja, pra nuk janë fjalë vendëse të hititishtes. Megjithatë, ato zbulojnë jo vetëm paralele leksikore, por edhe përputhje semantike e sintaksore, duke dëshmuar se modelet strukturore të trashëguara vazhduan të mbeten aktive edhe nën sipërfaqen e huazimeve, duke ushtruar ndikim në ndërtimin gjuhësor të hititishtes.

Korrespondenca të tjera e përforcojnë këtë prirje. Një rast i veçantë paraqitet me hit. *hāppar-* që përkon si në formë ashtu edhe në kuptim me shqipen *k(h)apar* > *kapar* 'pagesë paraprake, kapar, garanci' (krahaso *para-a, paradhënie* dhe *kap(je)/ kapur* = *kapar*). Edhe pse *kapar* është konsideruar zakonisht si huazim nga turqishtja ose italishtja, paralelja fonetike dhe semantike me *hāppar-* sugjeron një shtresë shumë më të hershme të fjalorit të përbashkët që pasqyron terminologjinë juridiko-ekonomike të trashëguar nga indoevropianishtja.

Për fund mund të thuhet se korrespondencat hitito-shqipe tregojnë se mjaft leksema të shqipes, të cilat tradicionalisht janë

konsideruar si huazime nga latinishtja ose greqishtja, në fakt janë të trashëguara ose të rrënjosura thellë në substratin indoevropian. Ndikimet latine, greke, sllave dhe osmane janë të pranishme, por dytësore, duke prekur më tepër fjalorin e përditshëm ose terminologjinë e specializuar, ndërsa bërthama leksikore e shqipes ruan një vazhdimësi të thellë me hititishten dhe me substratin indoevropian. Kjo bërthamë reflekton një ndërthurje të ndërliqshme midis konservimit, inovacionit dhe zgjerimit semantik.

Ajo që e bën lidhjen hitito-shqipe fare të rëndësishme nuk janë ndikimet e jashtme, por trashëgimia e përbashkët indoevropiane, qëndrueshmëria e përkimeve dhe gjurmët e mundshme të kontakteve të hershme gjuhësore të cilat prekin jo vetëm leksikun, por në njëfarë mase, edhe vetë strukturën gramatikore.

Paradigmat semantike hitito-shqipe

Në vazhdim do të shqyrtohen disa rrënjë hitite – veçanërisht nga sistemi foljor dhe ai emëror – që paraqesin paralele të qarta me shqipen dhe që mund të konsiderohen si paradigma semantike në të dy gjuhët, duke shërbyer si raste ilustrative të korrespondencave të trashëguara indoevropiane dhe të zhvillimit të përbashkët semantik.

Këto paradigma tregojnë se si rrënjët e veçanta gjenerojnë rrjete të gjera kuptimore që shtrihen nga një inventar gjërash konkrete te fushat shoqërore dhe simbolike. Ato ruajnë jo vetëm realitete materiale, por edhe modele kulturore, ritualeske e metaforike, duke dëshmuar se si shqipja ka ruajtur veçori strukturore e semantike arkaike, shpesh më të afërta me hititishten sesa me degë të tjera të familjes indoevropiane. Korrespondenca të tilla ofrojnë një pasqyrë të çmuar mbi organizimin konceptual të mendimit të hershëm indoevropian.

Paradigma *arai-*

Një vështrim të veçantë meriton fjala hit. *ariya* ‘orakull; ngritje’, e cila në disa nivele domethënieje përputhet me *ora*-n shqipe, që në mitologjinë shqiptare reflekton kuptimin e një qenieje mitologjike mbrojtëse për çdo njeri dhe njëkohësisht të një ‘nimfe mali’, apo dhe të një ‘orakulli’ e ‘fatthënëseje’.

Pra, fjala *ora*, duke përfshirë edhe kuptimet e *nimfave të malit* dhe të *orakullit*, na dëfton një qenie gjysmë-hyjnore mbrojtëse, të aftë të marrë forma të ndryshme – si njeri, shpend, dhi a gjarpër – shpesh e përdorur në trajtë sinonimike me *zanat* dhe *shtojzovallet* apo me *zana malesh* (Lambertz 1958; Elsie 2001). Po këso tiparesh gjysmëhyjnore të *orës* pasqyrohen edhe në formën *ari-* në mesapishte (Mani 2025, 261).

Duhet kujtuar se ora në shqipe ndonjëherë është shpjeguar si huazim nga format latine apo greke dhe është barazuar veçanërisht me ital. *ora* ‘kohë’ (Topalli 2017), meqë ndan të njëjtin kuptim si ‘njësi kohe’.

Megjithatë, përputhjet me hititishten dhe mesapishten e bëjnë *ora*-n një formë jashtëzakonisht arkaike me kuptime mitologjike (Lambertz 1958; Elezi 2009), si figurë që ofron mbrojtje dhe përcjell zërin parathënës dhe fatin nga orakujt, duke qenë e lidhur me hyjnitë. Ora ecën paralelisht me figurat mitologjike shqiptare *zanat* dhe *shtojzovallet*, me kuptime të përafërta, si dhe me simbolikën e *dhive* dhe *gjarprit* (ky i fundit deri diku i krahasueshëm me hit. *illiyanka*), duke shfaqur kështu rrënjët mitopoetike të imagjinares indoevropiane, që përfshin adhurimin e shndërruar në sublimë (Freidenberg 1997; Carlyle 1908; Burke 1998).

Ora/ ori është e pranishme gjerësisht si një substrat themelor fjalëformues në epikën dhe rrëfimet e vjetra shqiptare, duke marrë tipare të Herës së Olimpit, ndërsa në religjionet abrahamike, më vonë, bëhet ‘motër’ me figura si hebr. *mal’ak* ‘i dërguar, lajmëtar’, gr. *ἄγγελος* dhe më pas arab. *malika* ‘engjëll; melaqe’.

Vetë karakteri i orës iliro-shqiptare është trajtuar si një amalgamë e jetës personale dhe fisnore. Secili njeri apo fis e ka orën e vet; madje edhe me ngjyra të ndryshme, sa malësorët i ndajnë orët në tri radhë:

> "E para asht e bardhë si dielli, e i ep njeriut të mira; e dyta asht e verdhë, e nieri ka prej saj jetë të keqe; e treta asht e zezë e i përtërin njeriut dekën. Seicilli fis asht i ruejtun prej nji Ore, qi e drejton ndër fatet e tija. Tek des nieri edhe Ora shkimet me te."
>
> (Harapi 1961, 277–78)

Pra, me vdekjen e orës vdes edhe shpirti njerëzor apo *hija* e tij.

Në thelb, ora shqiptare ka tipare hyjnore; mund të shfaqet, të zhduket dhe të fluturojë, por është gjithashtu një figurë vdekatare, që mund të marrë forma të ndryshme, sidomos atë të dhisë. Ora është *ori* mesap që njihej si shoqëruese e hyjnisë Pan, dhe bëhet emri i qytetit të parë mesap Hyria > Oria. Kur merret parasysh migrimi i mesapëve në Itali rreth periudhës së rënies së Trojës, nuk është e rastësishme që *ora* lidhet me kuptimet hit. *ariya-/ āran; urayanni-; ari-* dhe derivatet e tjera që zakonisht tregojnë orakullin, fatthënësin, që në kulturën shqiptare përkon me atributet parathënëse dhe mbrojtëse të orës.

Sigurisht, ky koncept ka marrëdhënie edhe me burime joindoevropiane, si egjyp. *hora* 'fajkua; i lartë', ndërsa lidhet më ngushtë me shtratin kulturor indoevropian, me korrespondenca të mundshme, si: gr. *ὀρεστιάς* 'nimfë mali', *ὀρέστερος* 'i maleve, drangua, ujk', *ὄρχαμος* 'udhëheqës, njeri me orë (pushtet)', si dhe emri personal *Ορέστης* 'i biri i Agamemnonit' (emër që del si atribut i zanës së malit), apo dhe *ὥρη* 'stinë'; lat. *oread* 'orë mali', *oraculum* 'orakull, shpallje hyji'; ital. *ora* 'kohë'; shih dhe emrin e qytetit të Epirit, *Ὥρικον~Ὥρικος*, lat. Oricum~Oricus (shqip: Orikum), krahas emrit Oria (< Hyria), qytetit të parë mesap; arm. *ori, orlor, ors* 'korb; lloj zogu; gjah'; got. *ara* 'shqiponjë'.

Bonnet vëren se gjeografia dhe mitologjia na ftojnë ta shohim këtë fjalë si një refleks të gr. *Ὧραι* apo edhe *Ἥρα* 'Hera', duke i përafruar këto edhe me fjalën shqipe *(h)erë* (Bonnet 1998: 230). Shih po ashtu gr. *ὀρθόω*, aor. *ὤρθωσεν* 'udhëtoj (drejt), ngrihem', si dhe mitin e Orionit (gr. *Ὡρίων / Ὠαρίων*; lat. *Orion*). Në shqip, ora ka dhënë edhe kompozita si: *o+roe* 'është roje; vëroe / rue > vëren'.

Orët, si qenie hyjnore dhe mitologjike, kanë peshë të jashtëzakonshme në jetën iliro-shqiptare. Elsie me të drejtë i quante ato *fairy godmothers*; po ashtu Nopça i lidhte ato me Oreadat e Greqisë së lashtë, si nimfa malesh (Elsie 2001: 194). Nëse ora mund të krahasohet me ndonjë nga figurat e hyjnive të Olimpit, ajo do të ishte Hera. Megjithatë, në pikëpamje të origjinës, ora nuk përjashtohet të ketë lidhje me mitin e Orionit (*gr. Ὡρίων*), gjuetarit gjigant që Zeusi e dënoi dhe e dërgoi në qiell, prej nga ai shfaqet si konstelacion yjor. Prandaj ora e ka të përbrendësuar *ori(on)*-in edhe si një lloj orakulli që, si i tillë, gjendet edhe në traditën hitite.

Së këndejmi, ora bëhet orakull, parathënëse dhe lexuese fati, njëkohësisht edhe mbrojtëse, që zakonisht vjen nga lart. Ky interpretim bëhet i besueshëm, pasi në traditën shqiptare *ora* – ashtu si figura të ngjashme në kultura të tjera të lashta – mund të shfaqet jo vetëm si nimfë apo priftëreshë, por edhe në trajtë shpendi, shpesh si shqiponjë, simbol i ngritjes dhe ndërmjetësimit hyjnor. Fjala hitite *haran-* 'shqiponjë' (përkime: gr. *ὄρνις* 'zog', got. *ara* 'shqiponjë', nor. *örn* 'shqiponjë', irl. e vj. *irar* 'shqiponjë' < PIE **h₃er-on*) mund të përfaqësojë një arketip të zogut-orakull, si analog mitologjik i *orës* shqiptare.

Një lidhje e mundshme ndërmjet mitologjisë ktonike dhe qiellore të *orës* dhe figurës së *gjarprit* në traditën shqiptare mund të shtrohet duke krahasuar hit. *palla-*, të kuptuar si 'orakull gjarpër', me shqipen *bolla*, që emërton një lloj gjarpri mitologjik. Të dyja duket se ruajnë aspekte plotësuese të një shtrese të lashtë mitologjike – e para mishëron efekte profetike dhe

orakulare, ndërsa e dyta fuqi fatale dhe shkatërruese.

Në këtë kontekst, një lidhje me hititishten *arrai* 'të arrij; të ngjitem, të ngrihem lart' shfaqet semantikisht e qëndrueshme, duke reflektuar ndërlidhjen ndërmjet fluturimit, lartësisë dhe komunikimit hyjnor. Më tej mund të sugjerohet që sllav. *orl/ orao* 'shqiponjë', më shumë sesa të përfaqësojë një huazim nga sllavishtja në shqip, mund të jetë rast i kundërt: *orl* – i njohur në shqip si i tillë – mund të ruajë elemente të lidhjes me *orën e malit* apo orakullin, të mishëruar me zogun e hirit qiellor – shqiponjën.

Në hititisht, rrënja *ariya*, me format si *arai*- dhe derivatet e tjera, lidhet me kuptimin 'e përcaktuar nga orakulli i hyjnive'. Kjo rrënjë lidhet zakonisht me një rrjet më të gjerë leksikor, që përfshin lat. *oro* < *arayo* 't'u drejtohem, t'u lutem (perëndive)', *oraculum* < *ora-tlom* 'orakull', skt. *aryati* 'përmend, lavdëroj' dhe gr. jonike *ἀρή* 'lutje' (Puhvel 1984, 138). Rrjedhimisht, ajo zakonisht konsiderohet si e dallueshme nga PIE **h₃er-on*, pavarësisht disa korrespondencave fonetike dhe semantike të pjesshme.

Marrë përgjithësisht, afria fonetike dhe në masë të mirë edhe semantike mes *ariya* : *orë* flet për nevojën e një rishqyrtimi të këtij koncepti themelor në mitologjinë shqiptare, në raport me greqishten, latinishten dhe hititishten. Edhe pse këto forma mund të lidhen me rrënjë etimologjike të ndryshme, *ora* në shqip mund të kuptohet si një zhvillim paralel në raport me rrënjën hitite që shpreh këtë nocion, duke mishëruar role që përfshijnë orakullin, zogun-orakull (shqiponjën), nimfën orakullare, qeni-en hibride njeri-zog, madje edhe priftëreshën, ashtu siç shfaqet në traditat greke dhe, deri diku, latine. Fonetikisht, shqipja ka ruajtur formën themeltare *ora*-, ndërkohë që ka zgjeruar gamën e saj semantike në përputhje me evoluimet e konteksteve mitologjike e religjioze.

Paradigma *damme-*

Paradigma *damme-* 'dam/ dëm', një emër me derivime të gjera foljore në shqip, reflekton një korrespondencë të ngjeshur hitito-shqipe, si në fonologji ashtu dhe në semantikë. Format hitite si *damme(isha)* dhe derivatet e tyre gjejnë paralele të afërta në rrënjën shqipe *dam-* (p.sh. *dam, dëm(tim), i (n)damë, ndarje*), duke u shtrirë mbi një fushë të gjerë semantike që përfshin dëmtimin fizik, ndëshkimin, rregullimin social dhe ligjor, si dhe veprime rituale (që lidhen me flijime e sakrifica të cjapit etj.). Do kujtuar se marrëdhënia semantike mes *damme/isha* dhe foljes *tamass-/tame/iss-* 'shtyp' u identifikua fillimisht nga Götze (1930, 179).

Kjo paradigmë ilustron se si një rrënjë foljore e vetme përhapet në mënyrë metaforike nga veprimet konkrete drejt fushave abstrakte dhe institucionale, duke reflektuar një matricë semantike të përbashkët indoevropiane.

hititisht	**shqip**
damass-/damess-/tammas	*damis > damtoj, prish, shtyp-*
dammessa-	*damsa > damësi, dam(tim), dëm; dënim*
tamassuwanzi-	*damtuan, (i) dëmtuar*
dammeshan ak-	*damis dekë; vdekje nga dami/dëmi (dhuna)*
dammese-/dammeisha-	*dam(ë/tuar); vdekje nga dami/dëmi, me dëme*
dammessauwar-/dammeshanu-	*da-mëshuar/mëshuan, mëshuarje; damtim*

Vazhdimësia fonologjike e rrënjës – pavarësisht ndryshimeve të brendshme në hititisht (dyfishimi, ngjyrosja laringale) dhe ruajtjes së drejtpërdrejtë të *d-s*ë në shqip – dëfton një trashëgimi

që nuk është e rastit apo rezultat i huazimeve të mëvonshme.

Ashtu si paradigma të tjera, *damme-* tregon se vazhdimësia e hershme indoevropiane ndiqet më besueshëm përmes rrjeteve semantike dhe botëve të mendimit metaforik sesa përmes përputhjeve leksikore të izoluara. Shqipja, duke ruajtur këtë kornizë konceptuale dhe bërthamën leksikore, shfaqet si një dëshmitare kyçe e këtyre rrjeteve të hershme, duke nxjerrë në pah vlerën metodologjike të rindërtimit të të njohurit indoevropian dhe të semantikës kulturore nëpërmjet paradigmave, dhe jo vetëm përmes leksemave të veçanta.

Paradigma *alel-*

Përkimësia hitito-shqipe *alel-*: *lule* spikat mes gjithë 'lulesh' korresponduese. Në të dy gjuhët, kjo rrënjë shpërfaq një gjallëri semantike dhe një frytshmëri morfologjike të jashtëzakonshme krahasuar me gjuhë të tjera të lashta dhe moderne, duke na sugjeruar një origjinë të mundshme egjeo-anatoliane të vetë konceptit.

Forma të ngjashme hasen në tërë hapësirën më të gjerë gjuhësore të Mesdheut (e më gjerë): cush. *lili*, berb. *alili*, bask. *lili*, est. *lill*, gr. *leirion*, lat. *lilium* dhe kopt. *hleli* 'lule' (krh. Benveniste 1954; Hubschmid 1960; Masson 1967; Hemmerdinger 1968, të gjitha *në*: Puhvel 1984, 33). Forma e përbashkët fonetike dhe semantike tregojnë për një substrat të përbashkët mesdhetar.

Si në hititisht ashtu dhe në shqip, një seri derivatesh dëshmon shtrirjen e gjerë semantike të kësaj rrënje:

alel- → *(a)-lul-*, *lule*, *lulëzim*;
aliles → *lule*, *lilak*, *ngjyra e jargavanit*;
alalessar- → *lulesar*, *lulishte*;
alila- → *lule (kushtuar një hyji)*;
lulu-/ luluwai- → *lulëzim*, mirëqenie.

Formacione fonetike dhe semantike të lidhura fort, e konfirmojnë më tej këtë rrjet:

alalu- ↔ *lulare, rrobë me lule*;
hulali- ↔ *luloj, zbukuroj*;
hulaliyea- ↔ *thurali/ lulim, thurje (me lule)*;
ulili- ↔ *lulishte, ultësirë, ullishtë?*

Forma shtesë si *alila, alilili, aliliya, alli-* mund të kenë qenë fillimisht të lidhura me *lulëzim* ose vegjetacion lulesh, shpesh të lidhur me zogj.

Fonetikisht, alternimi i zanoreve ndërkonsonantike *-e-*, *-i-* dhe *-u-* në *alel-* dhe derivatet e saj korrespondojnë me një *-u-* të qëndrueshme në shqip, duke funksionuar si një formant i përsëritur rrënjor përgjatë formave derivative.

Shqipja, si një gjuhë e lidhur historikisht me botën paragreke të Egjeut (Stadtmüller 1966: 56), mbase ndante lidhje të hershme kulturore dhe gjuhësore mesdhetare, me luvishten, hititishten dhe ndoshta edhe etruskishten. Ndërthurja e tyre në rajonin e Egjeut mund të ketë prodhuar leksemën *alel-: lule*, duke gjeneruar një fushë të gjerë semantike dhe konceptuale.

Struktura e përsëritur fonotaktike *l:l* në hititisht dhe në shqip e forcon këtë korrespondencë fonetike dhe konceptuale, duke manifestuar një trashëgimi të përbashkët. E tërë gama semantike – nga lulëzimi te livadhi, nga zbukurimi te begatia – shtrihet përtej kufijve të paraleleve greke, duke shenjuar një vazhdimësi hitito-shqipe të trupëzuar brenda një lekseme të bereqetshme indoevropiane.

Paradigma *app/epp*

Paradigma *app/epp* ‘marr, kap’ dëfton një dendësi të jashtëzakonshme korrespondencash midis hititishtes dhe shqipes. Përtej kuptimit themelor foljor ‘kap, marr’, këto forma shtrihen në një gamë të gjerë fushash semantike, përfshirë të drejtën, tregtinë,

veshjet, mjetet, ritualet dhe organizimin shoqëror. Kjo ilustron mënyrën se si izoglosat semantike mund të nxjerrin në pah vazhdimësi gjenealogjike dhe kulturore që shkojnë përtej krahasimeve të thjeshta fonologjike.

Forma hit. *app/epp* korrespondon me skt. *āpnoti* dhe lat. *apiscor*, duke reflektuar rrënjën PIE **$h_1$ep-* 'kap, marr' (Hrozný 1917; Schrijver 1990). Nga ana tjetër, lat. *capere*, shq. *kap* dhe lit. *kãpti* rrjedhin nga rrënja tjetër IE **kap-* 'kap, marr, grabis', e karakterizuar nga një nistore velar *k-* dhe jo nga nistorja laringale *h_1-* e rrënjës së parë. Sado që janë formalisht të ndryshme – *h_1-* nuk bëhet *k-* – këto rrënjë konvergjojnë semantikisht dhe të dyja kontribuojnë në kuptime të zgjeruara në shqip, për shembull *happzi* → *kap*, *ngjis*, mes tjerash.

Kjo paradigmë është parë poashtu në lidhje me rrënjën hitite *pai-/ pi-* 'jap', e interpretuar si rrjedhim nga **h_1p-(o)i-* e **$h_1$ep-* (Kloekhorst 2008, 242), duke sugjeruar një rrjet më të gjerë semantik dhe morfologjik ku rrënjët IE për kapjen, marrjen dhe dhënien janë mjaft të ndërthurura.

hititisht	**shqip**
app-	*kap*, *zë*
appanna	*kapun*, *zënë*
appant-	*i kapun*, *i burgosur*
appala-	*kapëse*, *kurthë*
appatar-	*kaptuar*, *kuptuar*, *kapur*
appatariya-	*e kapët(rri)*, *që merret*
appisk-	*kapish*, *kuptoj*
ep- / ap-	*kap*, *marr*
appant	*kapun*, *i kapur*
happzi	*kap*, *ngjis*
hahhapattar-	*(e) kapur, ngjitur*

hititisht	**shqip**
hapai- / hapi- / hapuwai	*(i) kapur*
hāppar-	*kapar*, *paradhënie*
hapkiri- / happutri-	*kapistër = zgjedhë*
hapti-	*hapëse-kapëse dekorative*
happu-	*(i) kapur, ngjitur*

Korrespondencat hitito-shqipe që gjenerojnë brenda paradigmës *app/ kap* zbulojnë një zgjerim metaforik sistematik të kësaj rrënje themelore foljore.

Në nivelin më konkret, rrënja shpreh kapjen fizike: *app-: kap.* Nga ky kuptim bazë, fusha semantike shtrihet në mënyrë të natyrshme drejt 'kapjes' së personave a objekteve, si në *appant-* → *i kapun* 'i mbajtur rob, i burgosur', dhe drejt nocioneve të lidhjes dhe bashkimit, të ilustruara nga *happzi* → *kap, ngjis*.

Zgjerimi semantik vazhdon në fushat më abstrakte. Forma të tilla si *appatar-* → *kaptuar*, *kuptuar* ilustrojnë shtrirjen e rrënjës foljore drejt kuptimit konceptual, duke treguar se si kapja fizike informon metaforikisht kapjen kognitive. Në mënyrë të ngjashme, në punë tregtie e shkëmbimi social, hit. *hāppar-* jep shq. *kapar, paradhënie*, duke shprehur aktin e *marrjes* në kontekste ekonomike ose transaksionale. Edhe fjalori i mjeteve dhe artefakteve – për shembull: *hapkiri-, happutri-* → *kapistër = zgjedhë* ose *hapti-* → *hapëse = kapëse* 'zbukurim dekorativ' – reflekton të njëjtën vazhdimësi semantike, duke treguar se nocionet e kapjes dhe bashkimit përshkojnë gjithandej objektet praktike dhe simbolike.

Fonologjikisht, këto modele nxjerrin në pah rrënjë PIE të veçanta që konvergjojnë semantikisht me format në shqip. Forma hit. *app-/ epp-* rrjedh nga PIE *h_1ep-, ku nistorja laringale zhduket ose zgjatet zanorja duke ruajtur stopalen labiale *p*. Nga

ana tjetër, shq. *kap* dhe lat. *capere* rrjedhin nga PIE **kap*-, duke ruajtur stopalen velare inciale dhe duke reflektuar një variant ekspresiv ose të sforcuar, që thekson *kapjen* e beftë a të rrëmbyeshme. Edhe pse formalisht të dallueshme, këto rrënjë bashkohen semantikisht në shqip, duke prodhuar një rrjet kuptimesh që shtrihet natyrshëm nga kuptimi literal te ai abstrakt.

Marrë në përgjithësi, paradigma *app/epp* → *kap* ilustron ruajtjen, zgjerimin dhe bashkimin e pjesshëm të rrënjëve PIE nëpër fusha të shumta semantike. Korrespondencat përfshijnë veprimtari konkrete, kuptime konceptuale, shkëmbime sociale dhe praktika rituale, duke reflektuar vazhdimësi nga proto-indoevropianishtja tek hititishtja dhe shqipja. Dendësia dhe qëndrueshmëria e këtyre përkimeve e bëjnë të pamundur që ato të jenë vetëm rastësi ose të shfaqen si huazime të mëvonshme. Përkundrazi, ato shpërfaqin qëndrueshmërinë e një matrice semantike indoevropiane. Një rast si ky tregon edhe nj herë se si një grup i vogël rrënjësh foljore mund të gjenerojë një rrjet leksikor të pasur dhe të kuptimshëm nga ana sociale, ku shqipja ruan reflekse të pasura nga të dyja rrënjët: **h₁ep*- dhe **kap*-.

Paradigma *ispar-*

Rrënja hitite *ispar*- ‘shpërndaj, përhap’ është atestuar në disa degë të familjes indoevropiane. Greqishtja e ruan kryesisht në foljen *σπείρω* ‘shpërndaj, mbjell’. Dëshmitë hitite si *isparra*- dhe *isparr*- ‘shkel me këmbë, shprish’ (Kloekhorst 2008, 208) shpërfaqin një spektër të gjerë semantik që përfshin shpërndarjen, ndarjen, derdhjen, thyerjen, madje edhe shmangien a largimin – shpesh në përkim të plotë me shqipen *shpërndaj*, *shprish*, *shpor*.

Në fakt, shqipja dëshmon një vazhdimësi të jashtëzakonshme semantike dhe fjalëformuese me këtë rrënjë. Rrënja hit. *ispar*- përkon ngushtësisht me formimin foljor në shqip *shpërndaj*,

prefiksi i të cilit, *shpër-* – që rrjedh nga një grup i mëhershëm ndajfoljor *sp-/shp-* – është zhvilluar në një element morfologjik tepër prodhimtar. Në shqip, ky grup ndajfoljor i lashtë, indoevropian, mbijeton si prefiks i gjallë, duke ruajtur kuptimet origjinale ndarëse dhe shpërndarëse, duke vazhduar të gjenerojë një gamë të gjerë derivatesh të reja.

Kuptimi i *ispar-* është interpretuar në mënyra të ndryshme, përfshirë mundësinë e prejardhjes së tij nga rrënja PIE **sperH–* 'shkel, shtyp me këmbë, shklas', por e dallueshme nga *isparrai-*, përderisa format e tjera konsiderohen zhvillime dytësore, sado që të afërta me gr. *σπείρω* 'përhap' (Oettinger 1979, 267; Melchert 1994, 80). Formimi në shqip s*hprish* 'shklas, shpërndaj' shpërfaq të dy dimensionet semantike që i atribuohen *ispar-*/ *isparrai-* – pra *shpërndaj* = shprish 'shpërndaj; shklas' – duke ruajtur mbivendosjen e lashtë midis *shpërndarjes* dhe *shtypjes* përmes shkeljes, një tipar tipik i zgjerimeve të hershme metaforike indoevropiane.

Pa mëdyshje, rrënja shqipe *shpër-/ shpar-* ruan pothuajse gjithë diapazonin semantik të hititishtes, duke u zhvilluar në një sistem prefiksal tepër prodhimtar. Prefiksi i ndërtuar *shpër-* mbetet një element i gjallë që vazhdon të krijojë fjalë të reja, dhe në disa raste është reduktuar më tej në grupin bashkëtingëllor *sp-*, mbase nëpërmjet zhvillimeve aglutinative.

Megjithëse e afërt në formë, rrënja *ispart-* 'shpurdh, shmangem, ik' dallon nga *ispar-*. Në shqip ajo shpreh kuptime si 'shpurdh, largohem, përpiqem me duar e këmbë, përleshem', duke korresponduar semantikisht me forma sanskrite, gote dhe armene. Por, nga ana tjetër, *ispar-* dhe *ispart-* formojnë një rrjet paralelesh semantike, mbase të lidhura edhe me *ispand-* 'derdh, bëj *libare*'.

Marrë në tërësi, këto na vijnë si dëshmi që shqipja ruan reflekset më arkaike e konservatore të të dyjave formave, *ispar-* dhe *ispart-* ndër gjuhët indoevropiane të gjalla – duke mbajtur jo vetëm shumë nga gjerësia semantike e hititishtes, por edhe

duke e zgjeruar atë përmes zhvillimeve të reja fjalëformuese, ndryshe nga greqishtja apo latinishtja, të cilat e kanë ngushtuar ose veçantësuar tepër kuptimin origjinal.

Paradigma *ulippana-*

Një propozim veçanërisht intrigues lidhet me mundësinë e një lidhjeje ndërmjet hit. *ulippana-* dhe luv. *ulipna-/ walipna-*, në njërën anë, dhe toponimit me prejardhje ilire *Ulpiana* në territorin e sotëm të Kosovës, në anën tjetër – që shfaqet ndonjëherë edhe në format si *Ulcianum* në Dardani dhe *Olcinium* në Ilirinë e Jugut, Ulqini i sotëm (Çabej 1986 II, 242).

Ulpiana, e vendosur në Dardaninë e lashtë, gjatë periudhës romake u zhvillua në një nga qendrat më të rëndësishme urbane të rajonit, por dëshmitë arkeologjike dhe kërkimet gjuhësore sugjerojnë se themelet – mbase dhe vetë emri – rrjedhin nga një shtresë shumë më e hershme pararomake.

Edhe pse etimologjia e *Ulpiana*-s nuk është sqaruar përfundimisht, përgjithësisht pranohet se qyteti u themelua ose u rindërtua gjatë sundimit të perandorit romak Marcus Ulpius Traianus (r. 98–117 e.s.). Burimet historike dëshmojnë se *Ulpiana* lulëzoi veçanërisht në shekujt III–IV e.s. me titullin *Municipium Ulpiana Splendissima*, duke shërbyer si një nyje e rëndësishme komunikimi në Dardani dhe në rajonet përreth. Në këtë periudhë ajo ishte bërë edhe qendër peshkopale – peshkopi i saj, *Macedonius of Dardania de Ulpianis*, përmendet si një nga firmëtarët e Këshillit të Serdikës të vitit 342 e.s. I rimëkëmbur nga Justiniani I pas tërmeteve të mesit të shekullit VI, qyteti mori emrin *Justiniana Secunda*; megjithatë, përdorimi i vazhdueshëm i titullit kishtar *Episcopus Ulpianensis* tregon se toponimi i vjetër ruajti një prani të fortë kulturore e gjuhësore në kujtesën kolektive të rajonit (Berisha, Hajdari, Goddard dhe Mukai 2019; Shukriu 2014; Mirdita 1979).

Kjo rezonancë e qëndrueshme e emrit fiton kuptim të veçantë kur shqyrtohet krahas ngjashmërive të dukshme fonetike dhe

semantike midis formave anatolike *ulippana-, ulipna-/ walipna-* dhe toponimit ilir *Ulpiana*. Këto përkime mund të tregojnë për një vazhdimësi më të thellë që lidh trashëgiminë gjuhësore me traditat më të gjera kulturore dhe mitologjike.

Fjala hit. *ulippana-* do të thotë 'grabitqar; bishë (ujk?)', ndërsa ajo luv. *ulipna-/ walipna-* (adj. *ulipnassa/i-*) domethënë 'ujk', ardhur si përkim i drejtpërdrejtë me shqipen *ujk/ ulkonjë* dhe me toponimet *Ulpiana* dhe *Ulqin*. Këto reflekse rrjedhin nga proto-shqipja *ulk*, që buron nga PIE **úlk^{w}o-/ úlp-* 'ujk', një rrënjë kjo gjerësisht e dëshmuar në gjuhët indoevropiane. Ortografia latine te *Ulpiana*, veçan te grupi bashkëtingëllor *lp*, mund të reflektojë një formë të latinizuar të një grupi më të hershëm *lk* (*Ulkiana*), si një formë e mëhershme arkaike anatolike ose indoevropiane. Vazhdimësia anatoliko-ilire: hit. *ulippana-/ luv. ulipna/i-* me shq. *ulk-/ ulkonjë* – ruan në mënyrë të qëndrueshme fillimin *ul-/ ul(i)p-* duke ndarë të njëjtën fushë semantike me *ujk, grabitqar, bishë* (Ivanov 1965; Watkins 1972; Tischler 2016).

Roli i shenjtë dhe themeltar i ujkut në kontekste si anatolike ashtu edhe (post)ilire forcon koherencën simbolike të një toponimi si *Ulpiana*, që mund të interpretohet si *Ulkiana*, 'qyteti i ulkonjës (ujkonjës)'. Në burimet hitite dhe luviane, ujku funksionon si simbol i së egrës hyjnore, ndërsa në mitologjinë dardane e ilire shfaqet si paraardhës dhe mbrojtës totemik. Ngjashëm mitit themeltar të Romës, të lidhur me *lupa*-n, *Ulpiana* dardane mund të ketë pasur si figurë mbrojtëse ose amësore *ulkonjën*. Ky interpretim fiton peshë nga vazhdimësia semantike dhe fonologjike e formave shqipe *ulk/ ujk* dhe *ulkonjë*, që sugjerojnë një rrënjë shumë të lashtë anatoliko-ilire **ulk, *ul(i)p*, me kuptimin 'grabitqar' ose 'ulkonjë' (krh. Lehrman 1987; Kloekhorst 2008; Tischler 2016).

Pra, *Ulpiana* nuk duhet kuptuar thjesht si një *Ulpiān(a)* romake e *Ulpii/ Ulpëve* (*gens* Traiana), sa si një refleks i latinizuar i një emri ballkanik më të hershëm *Ulkiana* ose *Ulkonja*, në kuptimin 'vend kulti, faltore e ulkonjës'. Ky

interpretim përputhet me një shtresë leksikore të dëshmuar në Anatoli dhe në Gadishullin Ilirik: hit. *ulippana-* 'grabitqar, bishë (ujk?)' dhe shqip *ulk/ ujk/ uk* 'ujk' (me fem. *ulkonjë/ ujkonjë/ ukinë*). Format PIE **ulk-*/*ulp-* me kuptimin 'ujk, grabitqar' mund të kenë dhënë *ulippana-* nëpërmjet sufiksimit dhe geminimit anatolik dhe refleksit shqiptar *ulk-* > *ulkiana* përmes formimit toponimik dhe ortografisë së mëvonshme latine *Ulcinium* → shq. *Ulqin*. Ky grup mund të reflektojë qoftë një trashëgimi të drejtpërdrejtë nga një refleks i arealit PIE, qoftë një formim të hershëm substrativ që ruajti motivin e 'ujkut' në shtresat anatolike dhe iliro-trake (Ivanov 1965; Watkins 1972; Tischler 2016).

Marrë në tërësi, pavarësisht lidhjes tradicionale të kësaj fjale me familjen romake *Ulpii,* dëshmitë onomastike, morfologjike dhe mitologjike mbështesin interpretimin e *Ulpiana*-s si një prezervim të toponimit të lashtë me 'ujk/ ulkonjë' (*Ulkiana/ Ulkonja*), të mbishtresuar ose riinterpretuar më pastaj përmes titullaturës romane.

Së këndejmi, qyteti shqiptar Ulpiana, ashtu si Ulcinium/ Ulqin, mund të korrespondojë fonetikisht, semantikisht dhe kulturalisht me hit. *ulippana-/ ulipna-* dhe, ndoshta, me format paraardhëse ilire. Emri *Ulcinium* mund të shpjegohet përmes proto-shqipes *ulk* > *ujk* 'ujk' dhe *ulkonjë* 'ujkonjë', duke sugjeruar që Ulpiana, e njohur nga burimet romake si një *municipium* në Dardani, mund të përfaqësojë një përsëritje të *Ulcinium/ Olcinium*. Toponime dhe antroponime të tjera të afërta, si *Ujkan* (emër mashkullor) dhe *Ajkuna* (emër femëror), ruajnë po ashtu këtë rrënjë, që reflekton hit. *ulippana-* 'ujk' (krh. Tischler 2016, 397).

Megjithëse burimet romake ia atribuojnë themelimin e Ulpianës Marcus Ulpius Traianusit (Trajanit), ky interpretim duket se mbivendos një toponim më të vjetër vendës, të prejardhur nga një rrënjë dardane ose trake të lidhur me ujkun, *ulk/ ulp*, që më vonë u riinterpretua ose u latinizua si *gentilicium*

romak. Duhet kujtuar se edhe vetë emri *Ulpius* mendohet se rrjedh nga një formë umbrike e ngjashme me lat. *lupus* 'ujk' ose *vulpes* 'dhelpër' (Melchert 1994), duke reflektuar një trajektore semantike të krahasueshme me termin hitit, çka përforcon këtë lidhje etimologjike të lidhur me ujkun.

Pa mbulesën e saj romake, *Ulpiana* – ashtu si *Ulqini* – mund të lexohet si *Ulkiana/ Ulkonja*, 'vendi i ujkut/ ujkonjës', duke ruajtur njëkohësisht mundësinë që emri të ketë funksionuar edhe si *gentilicium* personal. Ky lexim përkon me rolin e shenjtë dhe mitologjik të ujkut në traditat anatoliane, ilire dhe indoevropiane, ku ujqërit shfaqen si rojtarë, paraardhës totemikë dhe simbole të fuqisë themeluese ose mbrojtëse. Kështu, Ulpiana përfaqëson një vazhdimësi të latinizuar të një toponimi vendas të 'ujkut', që njëkohësisht nderon *gens*-in e Trajanit dhe ruan një substrat kulturor e mitologjik anatolian-egjean. Një model i ngjashëm vërehet në *Ulpia Traiana* në Daki (Rumaninë e sotme). Në Greqi, toponimi arkadik *Λύκαιον* pasqyron një vazhdimësi të ngjashme semantike dhe mitologjike. Që nga Mesjeta e më vonë, disa qytete në rajonet sllave mbajnë emra që nënkuptojnë 'ujk', si *Vukovar* (Kroaci) dhe *Vlkava* (Çeki), megjithëse këto janë zhvillime sllave të mëvonshme.

Nëse korrespondenca fonetike *ulippana* → *Ulpiana* është e saktë, ajo përforcon ekzistencën e një substrati të përbashkët anatoliano-egjean, duke treguar se si titujt perandorakë romakë mbivendosen mbi trashëgimi gjuhësore vendëse, duke ruajtur njëkohësisht peizazhe simbolike pararendëse të rrënjosura në imazherinë e ujkut.

Është po ashtu e mundshme që *ulippana-* të mbajë një lidhje semantike me rrënjën *uwalh-/ walh-* 'godas, luftoj, përballoj', që reflekton tiparet grabitqare të ujkut. Kjo lidhje përputhet me shqipen *sulmoj* dhe *godas* 'sulmoj, godas'. Derivate si *walhanai-/walhanni* 'sulem, godas' dhe *walhessar/ walhesn* 'sulm' korrespondojnë semantikisht me lat. *vello* 'ndaj, shkul', shq. *vras* 'vras', gr. *ἐαλών* 'u vra', dhe tok.A *wāllāstāre* 'vdes' < PIE

**welh₃-ti* (Kloekhorst 2008, 945–946). Kloekhorst gjithashtu nënvizon *u̯alku u̯a* si ‘diçka negative’ (2008, 950), ndërsa Tischler interpreton *walkuwan* si ‘bishë, hordhi, kafshë’ (2016, 419), që afrohet semantikisht me shqipen *ulkonjë*. Lehrman propozon që *u̯alku u̯a* mund të jetë burimi i *úlkʷo-* ‘ujk’, siç shihet në skt. *vṛtka* dhe gr. *λύκος*, duke lënë të hapur marrëdhënien e saj me skt. *a-vṛka* ‘i sigurt’ < *ulkwo* ‘i rrezikshëm’ (Lehrman 1987, 16–17). Lehrman gjithashtu sugjeron se *úlkʷo-* ka një refleks në luvishten kuneiforme *u̯alu̯a*, të interpretuar si ‘luan’ (1978, 228–230), që ndoshta ka ndikuar mbi shqipen *luan*, duke formuar një lidhje semantike ndërmjet luanit, ujkut dhe ujkonjës. Luv. *walwa/i-* pasqyron në mënyrë të ngjashme format hitite, duke lidhur më tej sferat mitopoetike anatoliane me ato mediterrane e ilire (krh. Lehrman 1978, 228–230; Tischler 2016a, 271).

Një mbështetje tjetër ndaj kësaj vazhdimësie vjen edhe nga zhvillimet e likuid-silabave: PIE *l̥* > *ul/ol/la* (variante areale), ndërsa fillestarja PIE *w-* mund të vokalizohet në *u-* ose të humbë apo asimilohet në disa reflekse regjionale, në përputhje me zanoren nistore në shqipen moderne *ujk*. Geminantet hitite *pp* në *ulippana-* mund të pasqyrojnë një formim me ndërfutje të ndonjë formimi me stopale a derivim pasiv (*-pana*) mbi bazën *uli/ ulp*, ndërsa korrespondenca *ulp/ ulip* ↔ *ulk* mund të shpjegohet përmes humbjes rregullare të zëshmërisë ose ristrukturimit morfologjik nëpër kalime të ndryshme përbrenda degës gjuhësore.

Këto korrespondenca fonologjike dhe morfologjike mbështesin hipotezën se *Ulpiana* dhe antroponimet e ngjashme ruajnë paradigmën anatoliano-ilire *ulk/ ulip*.

Edhe nga këndvështrimi kulturor, shq. *ujk* jep *ujkeshë* ose *ukinë* > *ulkonjë*, një formë mitike që bashkon tiparet e ujkut dhe të përbindëshit drakonik, serpentin. Në traditën gojore, *ulkonja* shfaqet jo si një ukinë > ulkonjë e zakonshme, por si një hibrid dragua-gjarpër (Elsie 2001). Kompleksi ujk–dragua–gjarpër

është i përhapur në gjithë kulturat indoevropiane, nga India në Irlandë, i mishëruar në mite si hit. *Illuyanka* dhe gr. *Λύκος – Δράκων*, që përfaqësojnë betejën arketipale të Zotit të Stuhisë ose Luftëtarit kundër Kaosit. Në traditën shqiptare, *dragoi* shpesh shfaqet si hero pozitiv, përballë *kulshedrës* – përbindëshit femëror serpentin – ndërsa ujku mbetet një figurë mjaft ambivalente (krh. Bowra 1952; Graves 1955; Dumézil 1988; West 2007; Calin 2017).

Zinxhiri morfologjik *ujk* → *ujkeshë* → *ulkonjë* ndjek një transformim që nis nga natyrorja dhe ecën kah e mbinatyrshmja: *ujkesha* evoluon në *ulkonjë*, një figurë mitike femërore e pajisur me fuqi të frikshme e zjarrpritëse. Ajo fluturon, zvarritet si gjarpër dhe djeg armiqtë e saj. Ajo mishëron njëkohësisht mbrojtjen dhe shkatërrimin – një energji ambivalente që pasqyron botët hitite, greke dhe mesdhetare. Gjuhësisht, *ulkonja* ruan një variant arkaik të proto-shqipes *ujk*, me prapashtesën *-on(ë)/-onjë* që formon emra femërorë ose shton efekt veprimi. Kalimi zanor fillestar *u-* → *ul-* kujton format hitite *ulipna-/walipna-* dhe ndoshta PIE **ul-,*wel-,* të lidhura me lëvizjen spëdredhëse, serpentine, duke e bërë *ulkonjën* 'ujkonjë të dredhur, katullaqë', që mishëron shkrirjen indoevropiane të fuqive tokësore dhe nëntokësore (krh. Watkins 1995; West 2007; Bowra 1952; Dumézil 1988).

Karakteri i saj femëror dhe natyra nokturiale e saj lidhen edhe me *zanat* dhe *orët* – qenie me elemente nimfash, të pajisura me cilësi profetike dhe serpentine – duke formuar kështu një vazhdimësi fuqish demonike femërore. *Ulkonja* merr të njëjtin rol kozmik dhe shoqëror si *Illuyanka* ose *Vṛtra*: një entitet pragu, gllabëruese dhe rojtare, që mund të sjellë njëkohësisht kaos dhe mbrojtje. E krahasueshme me gr. *λύκος* 'ujk', ku rrënja *luk-* lidhet sa me dritën (*λύκη* 'agim'), po aq sa dhe me hyjninë *ujk* me elemente gjarpërore, *ulkonja* shkrin sferat solare me ato ktonike (Watkins 1995; Graves 1955; Dumézil 1968, 1988). Fundja, *ulkonja* nuk është vetëm një *ujkonjë*, por një *dragua-*

ujkonjë – një *Illuyanka* në formë femërore, e ruajtur në imagjinatën gojore shqiptare, një mbetje e një sinteze mitologjike indoevropiane arkaike. Ajo mishëron shembullin përbrenda mitologjisë shqiptare ku *ujku*, *dragoi* dhe *ulkonja* (shpesh të identifikuar me *bollën* a *kulshedrën*) shfaqen si qenie antagoniste, por dhe hyjnore, të lidhura me motin, pjellorinë, mbrojtjen dhe baraspeshën midis rendit dhe kaosit.

Etymon-trekëndshi: hititisht – mesapisht – shqip

Shikuar brenda një konteksti më të gjerë të marrëdhënies së shqipes me zonën gjuhësore e kulturore anatoliane, mund të vërehet një trekëndësh historik, fonologjiko-semantik, që lidh hititishten, mesapishten dhe shqipen. Një vëmendje të veçantë meriton hetimi i shtegut të semantikës së fjalëve hitite – ndonëse me burim nga një degë gjuhësore e veçantë – që duket se ka konvergjuar apo dhe bashkëjetuar me mesapishten, duke u ruajtur pjesërisht, përmes huazimeve dhe ndërfutjeve brenda gjuhës dhe kornizës kulturore të saj (krh. De Simone & Marchesini 2002; Mani 2025).

Një proces i tillë duket të ketë ndodhur, të paktën pjesërisht, përmes migrimeve nga brigjet e Anatolisë, në rajonin e lidhur me Dardanët dhe Brigët pranë Ilionit, drejt Italisë së Jugut, pas rënies së Trojës. Lëvizjet e tilla duket se kanë mundësuar integrimin e modeleve gjuhësore anatoliane brenda mesapishtes, krahasueshëm me atë që ndodhi në dialektet e tjera ilire, veçanërisht në dialektin epirot, i cili duket se ka qenë më i spikaturi dhe gjeografikisht më i shtriri (Mani 2025). Ndryshe nga mesapishtja, këto dialekte të tjera ilire nuk kanë lënë evidenca të shkruara, duke mbijetuar vetëm në formë gojore, sado që historikisht të njohura dhe duke u shtrirë në territoret e fiseve ilire të hinterlandit.

Kuvendimi i mëposhtëm shpërfaq një përzgjedhje korrespondencash hitite–mesape–shqipe, duke nxjerrë në pah

vazhdimësinë e ndërlikuar fonologjike, morfologjike dhe semantike që hedh dritë mbi ndërveprimet historike dhe kulturore në këto rajone. Kjo qasje jo vetëm që forcon rolin e mesapishtes si një urë gjuhësore midis Anatolisë dhe territoreve ilire, por gjithashtu ofron qasje kritike e material substrati për rindërtimin e proto-shqipes.

hititisht	**mesapisht**	**shqip**	**anglisht**
hāssuwas	hazzava-	hazava?/mbret?	king, prince
walla-/walliyatar	valla	valle, festim	celebration, praise
lāi	la	la/lë	to let, leave
āppa	bas	pas/prapa	behind
naš	nes	na/ne; nesh, neve	us/to us
aiš/išš-	ha(n)	ha(sh)/(gojë)	to eat/mouth
sīwatt-	sott-	sot/ditë	today/day
tahasis	tass	tas	cup/bowl
u̯it-	ui	ui/ujë	water
u̯ai/wai-	vai	vajtim; vaj	lament
atrahit	trohantes	trahana	sort of food
laḫuuzzi	lao	lau/laj/lahem	to wash
āššu-/dassu	daštas	(i/e) dashur; dua	to love/be strong
uppiya/upara	hiber	hipur, epërm	upper
ḫat-	θoav-	tha-/tharje	to dry
ḫaštāi	ast	asht	bone
anda	inθi	ndër/në	in
ariya-	ori	ora	oracle
hardu	ardano-	ardhun	comer
sah	sohi	shoh	to see/to search
maniḭaaḫḫ	mannati	mban	to hold

hititisht	mesapisht	shqip	anglisht
zah	zihi	za/zë/zihem	to grasp/to quarrel
kuis	kos	kush	who
parsiya-	preišr	prish(ur)	to ruin/break
(u)pai-	nab-	nap, jap	to give
zanu	zinn	zien; ziej	to cook
tuhussiya	hest	heshtja/pritja	to wait/be silent
tēkan	tok	tokë	land, soil
mallit-/militt	maltis	mjaltë	honey
genu-/ganu-	genus	gju(një)	knee
kars	kori	korr	to reap
witt-	vet(e)-	vit	year
keda	keshθet	kështu	in this way, so
alalessar	laolaos	lule(zim)	flower/bloom
-mi-/-ma-/-me-	emi/iam	imi/jam	my/i am

Më shumë se gjysma e njësive leksikore të paraqitura në këtë tabelë mund të konsiderohen përkime të njëmendta brenda këtij trekëndëshi a kornize krahasuese. Mesapishtja, sado që përfaqëson një gjuhë të veçantë, na dëfton për një spektër të veçorive të përbashkëta me hititishten, qoftë si trashëgimi areali, qoftë si konvergjencë leksikore, çfarë e bën atë një model të vlefshëm – sado që në dukje të parë paksa 'imagjinar' – mbi të cilin mund të rindërtohet proto-shqipja. Vendosja e të dhënave të mesapishtes pranë hititishtes – dhe, deri diku, pranë frigjishtes – lehtëson një rindërtim më të qartë të vetë mesapishtes duke hedhur dritë mbi transformimin e saj gradual drejt shqipes klasike. Shembujt e paraqitur më sipër përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të rrjetit më të gjerë të korrespondencave që lidhin këto gjuhë, shumë prej të cilave kanë lënë gjurmë të qëndrueshme në shqip.

Përfundim

Mbijetesa e fjalorit hitit në shqipen moderne – veçanërisht në dialektin gegë – edhe mund të duket fillimisht pa gjasmë, por përkimet e prekshme dhe zhvillimet paralele dëftojnë korrespondenca që konfirmojnë bindshëm që këto lidhje nuk janë rastisje.

Për mijëvjeçarë të tërë, zëra leksikorë themelorë – veçan ata që lidhen me praktikën rituale, organizimin shoqëror, kafshët, veshjet, enët, pjesët e trupit dhe foljet më themelore – kanë shfaqur prirje të rezistojnë ndaj zëvendësimit të tyre, duke ruajtur rrënjët e lashta.

Në bazën e të dhënave prej rreth 1,500 zërash a hyrjesh, janë disa qindra syresh që tregojnë përkimësi fonologjike, semantike e morfologjike të qëndrueshme me format e trashëguara, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga zëra korrespondencash që nënkuptojnë huazime ase dhe propozime më spekulative dhe me baza homofonike.

Sigurisht që këto korrespondenca nuk janë rastësore: ndryshimet e përsëritura të tingujve, modelet e derivimit dhe stabiliteti semantik formojnë së bashku një rrjet koherent që lidh hititishten dhe shqipen. Mbledhur me një, këto ofrojnë dëshmi të forta për ruajtjen e një shtrese arkaike të proto-shqipes, të lidhur me Anatolinë, shtresë kjo që reflektohet më pastaj, në forma të mëhershme, klasike dhe moderne të shqipes.

Zhvillimi historik i shqipes, me sa duket, shtrihet goxha përtej fazave të saj më të hershme të dokumentuara. Dëshmitë nga mesapishtja – tashmë e njohur si një fazë e hershme ose arkaike e shqipes – tregojnë për një sistem gjuhësor relativisht të qëndrueshëm, veçanërisht në fjalor, eptim dhe forma të ndryshme gramatikore (De Simone & Marchesini 2002; Mani 2025). Tashmë është e kuptueshme se para shekullit të 6-të p.e.s., shqipja duhet të kuptohet përmes thjerrëzës së proto-

shqipes, me paralelizma leksikorë dhe gramatikorë që e lidhin atë sa me greqishten homerike, po aq dhe me veçori të hititishtes dhe sanskritishtes.

Rrjedhimisht, proto-shqipja duhet rishikuar si një fenomen para-mesapik, që i paraprin Luftës së Trojës dhe migrimit japig–mesapik në Italinë jugore. Për më tepër, mesapishtja reflekton një gjuhë të formuar nga rrymimet e Egjeut, Epirit dhe Anatolisë – përfshirë zonat pranë Trojës – duke ruajtur po ashtu kontakte me frigjishten dhe greqishten e hershme dorike. Kjo e vendos proto-shqipen brenda peizazhit gjuhësor të Epokës së Bronzit, bashkëkohëse me hititishten (si proto-gjuhë) dhe të krahasueshme në lashtësi me proto-greqishten. Tiparet fonologjike tradicionalisht të përdorura për të përcaktuar proto-shqipen – si rindërtimi i zanoreve, nazalizimi dhe zhvillimet akcentuale – duhet rishikuar brenda këtij konteksti më të gjerë. Korrespondencat e këtushme semantike dhe fonologjike me hititishten dhe mesapishten mbështesin një model trashëgimie të thellë indoevropiane, dhe jo zhvillime të vonshme, të izoluara ose të ndikuara nga jashtë.

Së këndejmi, dega gjuhësore shqipe kuptohet më mirë-e-mbarë brenda një rrjeti më të gjerë që përfshin greqishten, armenishten, frigjishten dhe mesapishten; kjo e fundit duke shërbyer si shtresa më direkte arkaike e shqipes (krh. Hyllested & Joseph 2022). Korrespondencat leksikore dhe fonologjike me hititishten ofrojnë një substrat-dëshmi të mëtejme për këtë kornizë të thellë indoevropiane. Pothuaj i gjithë fjalori i trashëguar i shqipes – i shtrirë me rreth një mijë zëra (të trashëguar) brenda fjalorit më të gjerë etimologjik të Topallit (2017) – mund të konfirmohet përmes korrespondencave me njësitë leksikore të hititishtes.

Sigurisht, ky korpus leksikor nuk synon të vendosë marrëdhënie gjenealogjike mes këtyre gjuhëve, por të identifikojë pika domethënëse krahasimi midis hititishtes dhe (proto-)shqipes, veçanërisht aty ku mund të dallohen rrënjë të përbashkëta

indoevropiane. Rastet e korrespondencave hipotetike, spekulative ose të pasigurta, janë dhënë me italik dhe me pikëpyetje, për të nxitur hetim të mëtejmë filologjik dhe për t'u ikur përfundimeve të ngutshme. Megjithatë, nga një perspektivë më e gjerë gjuhësore, korrespondencat e identifikuara sugjerojnë që rindërtimi i proto-shqipes do duhej domosdo të zhvendosej në një fazë më të hershme kronologjike sesa 'indoevropianishtja e vonë' (Orel 2000).

Të tilla siç janë, korrespondencat që dalin nga ky leksikon, paraqesin një bazë për kërkime të mëtejshme mbi modelet semantike, fonologjike, sintaksore dhe derivuese, duke ndriçuar jo vetëm vendin e shqipes brenda familjes indoevropiane, por edhe pasurinë e qëndrueshme strukturore dhe leksikore të hititishtes si një arkë e gjallë e trashëgimisë së saj të lashtë.

On Hittite-Albanian Links

Although separated by both time and geography, Albanian and Hittite preserve notable commonalities that point to shared Indo-European inheritance, particularly in phonological and lexical domains. These parallels – though subtle and often obscured by millennia of independent development – offer promising ground for comparative inquiry. Yet, despite their potential significance, such connections have remained largely overlooked within Albanian linguistic scholarship, likely due to the relatively recent rise of Hittite studies, which only achieved prominence in Indo-European linguistics during the latter half of the twentieth century.

Once definitively classified as Indo-European, Hittite quickly assumed a central role in Indo-European linguistics, particularly as its archaic character challenged long-standing assumptions that had previously elevated Sanskrit as the earliest and most authoritative Indo-European language. Nonetheless, Hittite is not without complexity. Evidence of early contact with non-Indo-European languages – most notably Hurrian and Semitic – adds further layers to its historical and typological profile. Structurally, Hittite exhibits the hallmarks of an archaic Indo-European language: it is both synthetic, with derivational suffixes shaping word formation, and inflecting, marking the grammatical roles of most words in a sentence through a system of endings (Hoffner and Melchert 2008, 2).

Current debates focus on the extent to which Proto-Indo-European must be revised to accommodate the linguistic character of Anatolian, or, put differently, on determining which features of 'Core Indo-European' *(Restindogermanisch)* truly

represent common innovations not shared by Anatolian (Melchert 2017, 194; Rieken 2009; Oettinger 2013–14). Linguistic evidence alone, however, cannot decisively determine whether the initial entry into Anatolia occurred from the northwest or the northeast. While a northwest entry appears most plausible, corroborating evidence – such as shared innovations between Anatolian and western Indo-European dialects – remains desirable (Melchert 2003, 25–26). Within these Anatolian and northwestern linguistic-cultural currents, the potential role of Proto-Albanian, as reflected in the interplay between inherited Albanian vocabulary and Hittite lexical material, remains complex and unresolved, yet can be considered part of a broader linguistic 'dialogic imagination' that illuminates the historical-linguistic philosophy underpinning Proto-Indo-European origins.

From an earlier comparative perspective – one that also informs hypotheses regarding Proto-Albanian continuity – it has been widely maintained that the Anatolian branch of the Indo-European family, including Hittite, entered Asia Minor from the Thracian-Illyrian territories – most likely via the Bosphorus – during the third millennium BCE (Watkins 2008, 6). Supporting this broader Illyrian Peninsula–Anatolian nexus, traces of Illyrian names, alongside certain historical traditions, point to the presence of Illyrian groups beyond their attested homelands, extending even into Asia Minor (Wilkes 1996, 39). Within this framework, Vladimir Georgiev proposed that the Pelasgian language represented a transitional stage between Thracian and the Hittite–Luwian group – linguistically related to both, though identical to neither (1981, 88) – and further suggested that Hittite could play a crucial role in the interpretation of undeciphered Aegean scripts, including Cretan (Georgiev 1981, 91). In keeping with this discussion, Demiraj later posits that the pre-Indo-European populations of the Illyrian Peninsula and the Aegean coasts were not untouched by the cultural and linguistic

influences of the ancient civilizations of the Near East (Demiraj 2017, 32), whose sphere of extension at one point included the Hittite Empire. Furthermore, since the early twentieth century, a prevailing view has emerged that Illyrian represented an Indo-European substratum from which several branches of the European linguistic landscape subsequently developed (Wilkes 1996, 67).

It was precisely in the twentieth century that Hittite entered the scholarly scene, marking a decisive turning point in Indo-European studies. Following Bedřich Hrozný's initial decipherment in 1915 and his subsequent interpretative work (1917), the recognition and study of Hittite as an Indo-European language advanced through several stages, profoundly reshaping earlier conceptions of the Indo-European family and its prehistoric geography. Early contributions came from Forrer (1934) and Pokorny (1959), both of whom emphasized Hittite's Indo-European character. Following the Second World War, Hans G. Güterbock (1997) played a pivotal role by linking the Old and New Hittite states, in parallel with Bossert's work (1947) from another perspective. In the following decades, progress was carried forward by leading Anatolian specialists such as Melchert (1994), Klein, Hawkins and Çambel (1999), Tischler (2001, 2016), and Kloekhorst (2008). More specialized studies of particular aspects of Hittite were undertaken by Doncel & Lebrun (1983), Puhvel (1984), Van den Hout & Goedegebuure (1980–2019), and Yakubovich (2010). In addition, Indo-Europeanists such as Lubotsky (1998), Jasanoff (2003), Mallory & Adams (2006), Watkins (2010), and others have addressed broader comparative issues, situating Hittite within both general and specialized strands of Indo-European research.

The linguistic landscape of the ancient Near East and eastern Mediterranean can be understood as a series of 'gateways': Akkadian to Hittite, Hittite to Greek, and Greek to Latin.

Empires that embraced or reshaped languages were rarely ethnically or linguistically uniform, and the broader Anatolian context – including Akkadian, Sumerian, Hattic, Hurrian, Luwian, Palaic, and Mittanian Aryan – further enriched the Hittite linguistic mosaic. Even when transmission occurred indirectly, via political dominance rather than direct ethnic continuity, successive polities inherited and integrated elements of earlier linguistic traditions. Accordingly, the languages that developed in the aftermath of the Hittite empire should not be regarded as entirely new or independent entities. This perspective is supported by evidence indicating that several ethnic groups inhabiting the territory under Hattuša's control left indirect traces in the Anatolian cuneiform sources (Yakubovich 2022, 3).

There is, moreover, no reason to assume that Luwian and Hurrian speakers simply disappeared or were fully replaced after the fall of the Hittite empire. Anatolia must instead be understood as a crossroads of languages and cultures and a bridge of several different worlds (Giusfredi 2023, 2), where in fact "we just do not know which language(s) most inhabitants of the region used in their daily lives" (Giusfredi 2023, 106). The precise configuration of the Aegean linguistic areal in contact with the Hittite sphere remains uncertain, although Phrygian emerges as one of the most distinctively attested Indo-European languages in the post-Hittite landscape. Phrygian itself is generally considered a migrant language, introduced from the opposite shores of the Aegean, underscoring the complexity of migratory routes and earlier regional interactions that must be taken into account. Moreover, it has been suggested that in Troy – Hittite Wilusa or Truwisa – the local population spoke Thracophrygian, since the Trojans are often regarded as part of the Thracophrygian ethnos (Wooduizen 2017), despite evidence indicating that the Trojan population was ethnically heterogeneous. Other scholars, however, maintain that the Trojans

were Luwian and that the language of Troy was therefore Luwian (Watkins 1986; Bryce 2006; Macqueen 1986). Based on the arguments of Beekes (2003b), Kloekhorst has recently proposed that toward the end of the Bronze Age, an early form of Lydian was spoken in the eastern Anatolian region of Māša, while in the western area – particularly in Wiluša – the predominant language was Proto-Tyrsenic, the likely ancestor of Etruscan (2022a). These linguistic and cultural configurations must be understood within the broader context of the extensive migratory movements that characterized the late Bronze Age and its aftermath across Anatolia, the Aegean, and the territories of present-day southeastern Europe, encompassing both shores of the Adriatic.

In either case, the Indo-European background of Thraco-phrygian, Luwian, Proto-Tyrsenic, Lydian, and Hittite suggests that the Ancient Illyrians may also have formed part of the broader linguistic identity of the Dardanian Trojans. It is therefore noteworthy that the *Lesser Iliad* (from *Vita Homeri*) attributed to Pseudo-Herodotus, opens with a distinctly hymnic tone:

> Of Ilios I sing, and Dardania land of fine colts,
> over which the Danaans suffered much,
> servants of the War god.
> (West 2003, 125)

These opening verses evoke a world in which the Danaans endure the hardships inflicted by the Trojans of Dardania, a land intimately bound to the city of Troy (Ilios).

The Dardanians, without question, represent a key point of reference in the study of early Thracian–Illyrian–Anatolian interactions. Although Homer situates Mount Ida near Troy, within Dardanian territory, the ethnonym *Dardani(a)* appears to have originated in the wider region encompassing Dodona,

Epirus, and Thessaly – an area that may have functioned as a geographic and cultural nexus linking the Illyrian Dardania (with present-day Kosovo as its principal reference point) to the Dardania of the Troad in northwestern Anatolia. Classical authors such as Strabo and Apollodorus frequently associated these populations, implying a shared ancestry or enduring historical connection. The existence of a city named Dardanos near the Dardanelles lends further weight to this hypothesis. Given the relatively modest distance between the Balkan and Anatolian Dardanian regions (approximately 600–800 kilometers), such an identification appears not only plausible but compelling (Papazoglu 1969; Mirdita 1979; Wilkes 1996; Buqinca 2022).

From an archaeological perspective, the material evidence suggests that the interactions between Thrace and Anatolia during the Bronze Age provide valuable insights into their mutual contacts and, more broadly, illuminate the cultural and trade connections linking the Balkans with the Near East (Pavúk 2018, 275). These relations appear to have extended westward as well, bridging Anatolia with the Italic Peninsula.

Amid the vast migratory movements of peoples and languages, ancient tradition traced the link between these transcontinental Dardanians to Dardanus, the eponymous founder of the Trojan royal house, who, ruling over numerous tribes in Asia Minor, was said to have established the Dardanians west of the Thracians (Wilkes 1996, 145). Archaeological evidence may further support the possibility of cultural and religious continuities between the Dardanian region and broader Indo-European traditions.

A cultic artifact dedicated to the *Dea Dardanica*, discovered in present-day Kosovo (Verban, Vitia municipality) and dated to the 3-4th century CE, has been interpreted as indicative of a longstanding Dardanian religious and cultural identity (Shukriu 2014). This deity may have analogues in Asia Minor as well as

in regions of Roman Illyricum, suggesting the existence of a wider, possibly transregional, religious tradition with shared symbolic or ritual elements (Papazoglu 1969; Mirdita 1979; Stipčević 1989; Buqinca 2022).

From a cultural and mythological perspective, several ritual practices and symbolic motifs appear to link the Illyrian and Anatolian spheres. Beyond the tradition of ancestor totemism, examples such as the double-headed eagle – widely regarded as a shared totemic symbol – along with certain funerary rites and fertility cults, have been cited as evidence of parallel or inherited religious structures. Among the most frequently discussed are the Illyrian cults of the sun and the serpent, both of which appear to echo religious symbolism found in Anatolia (Stipčević 1989). In particular, comparisons have been drawn to the Hittite myth of *Illuyanka*, suggesting that serpent-related cultic motifs were not only prominent among the Hittites but may also have been shared with, or adapted by, Illyrian populations. These parallels point toward the transmission and transformation of Indo-European mythological elements, embedded within the everyday ritual and belief systems of these ancient societies (Rieken 2011).

The Hittite political and military landscape of the Late Bronze Age provides additional context. The city of Troy – referred to in Hittite sources as Wilusa – was within the Hittite sphere of influence. Local rulers, often operating as vassals, were bound by formal oaths of loyalty to the Hittite king and were obliged to defend Hittite interests in the region (Beckman, Bryce, and Cline 2011, 99–100). A significant agreement between the Hittite emperor Muwatalli II and the king of Troy, known as the Treaty of Alaksandu (Friedrich 1930; Bryce 2006; Starke 1999), established Wilussa under the protection of the Hittite empire. According to its terms, the Hittites were obligated to neutralize any threats directed against Wilussa (Konstantinopoulos 2023, 3).

During the renowned Battle of Kadesh (c. 1274 BCE), Egyptian records explicitly list the Dardanians among the allies of the Hittite coalition (Breasted 1906; Matić 2015). These documents – most notably the *Poem of Pentaur* and the *Bulletin of Kadesh* (Hallo and Younger 2003) – attest to the multinational composition of the Hittite army. If we accept that the Dardanians mentioned in these sources were ethnically Illyrian, their participation in such an alliance strengthens the case for early Illyrian–Hittite interaction, not only in military terms but potentially also in linguistic and cultural domains.

According to Georgiev (1981, 185–186), groups such as the Mysians, Mygdonians, and Dardanians migrated from the Thracian-Illyrian territories into Asia Minor as early as the first half of the second millennium BCE. This raises a critical historical-linguistic question: did the Dardanians carry with them a proto-Illyrian or early Albanian idiom that was subsequently influenced through contact with Hittite? Or do the observable similarities between Hittite and Albanian reflect a deeper, pre-migratory substratum? Both hypotheses are plausible and merit further investigation. From this perspective, the Dardanians may have acted as cultural and linguistic intermediaries, bridging Anatolia with the former Thracian, Hellenic, and Illyrian littorals. Despite being treated as separate in much of modern scholarship, these regions exhibit signs of contact and shared traditions, particularly in the Late Bronze Age.

From a linguistic perspective, contact between the speakers of Hittite and those of proto-Albanian may have facilitated the preservation or transmission of certain archaic Indo-European features within their respective languages. Georgiev (1981, 194) noted that Hittite is characterized by a mix of archaism and innovation – a description that could, with caution, be extended to Albanian. The growing number of proposed phonological and lexical cognates between Hittite and Albanian invites a

reevaluation of inherited Indo-European features that may reflect deeper layers of Thracian-Illyrian continuity, rather than direct descent or genetic relation to Anatolian. These potential correspondences should not be misconstrued as evidence of Albanian belonging to the Anatolian branch, but rather as remnants of shared archaic features once widespread across early Indo-European dialects.

This line of inquiry resonates with earlier hypotheses, most notably that of Norbert Jokl, who emphasized the close relationship between Illyrian and Thracian and, by implication, their Indo-European affiliations (1929, 278), a view subsequently refined and expanded by Bonfante through the recognition of links between Albanian, Greek, and Armenian (1978). Despite this, Albanian historical linguistics has traditionally prioritized research on contact phenomena with Latin, Greek, Slavic, and Turkish (e.g., Çabej 1986-7; Demiraj 1988; Topalli 2017), while connections with Hittite have been largely overlooked. This neglect may be partly due to the inertia of earlier Indo-European studies, which long focused on Sanskrit as the principal comparative model, and only later incorporated Anatolian data into the wider Indo-European framework.

The present study aims to reopen the question of potential correspondences between Hittite and Albanian – linguistic, cultural, or historical – with a view to reassessing long-held assumptions within Indo-European historical linguistics. This inquiry proceeds from the hypothesis that certain lexical and structural features shared by these languages may not be coincidental, but rather indicative of deeper historical processes that have yet to be fully understood. In doing so, it challenges rigid classifications within the Indo-European family and calls for a reconsideration of how linguistic boundaries have been drawn with respect to both time and space.

While Hittite, as an Anatolian language, and Albanian,

